




# STRATEGJIA E NVM 2025-2030



Nëntor 2025

STRATEGJIA  
E NDËRMARRJEVE  
TË VOGLA DHE TË MESME 2025-2030  
E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË  
VERIUT

Nëntor 2025



---

Ky botim mbështetet nga projekti i BE-së për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, i financuar nga Bashkimi Evropian.

Analiza dhe rezultatet në këtë botim I përfaqësojnë mendimet e autorëve dhe nuk I reflektojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

## Fjalim

Si Ministër i Ekonomisë dhe Punës i Republikës së Maqedonisë së Veriut, kam nderin të prezantoj Strategjinë për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme 2025-2030 të Republikës së Maqedonisë së Veriut, një kornizë gjithëpërfshirëse që përcakton udhëzimet për zhvillimin, konkurrueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e ndërmarrjeve tona të vogla dhe të mesme në vitet e ardhshme.

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme janë themeli i ekonomisë sonë. Ato përfaqësojnë pjesën më të madhe të ndërmarrjeve, ofrojnë mundësi punësimi për një pjesë të madhe të popullsisë dhe kanë një rol vital për nxitjen e inovacionit, zhvillimit rajonal dhe përgjegjësisë sociale. Forcimi i konkurrueshmërisë së tyre nuk është vetëm një domosdoshmëri ekonomike, por edhe një përparësi strategjike për arritjen e një rritje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, përmirësimin e pozicionimit ndërkombëtar dhe përafrimin e zhvillimit tonë me standardet dhe praktikën më të mira të Bashkimit Evropian.

Strategjia për NVM-të 2025–2030 bazohet në një vizion të qartë: Të krijojë një mjedis të favorshëm në të cilin NVM-të mund të përparojnë, të zgjerohen dhe të krijojnë inovacione. Ajo është zhvilluar përmes një procesi gjithëpërfshirës të bazuar në fakte, që përfshin konsultime të gjera me përfaqësues nga sektori privat, institucionet publike, akademika dhe shoqëria civile. Qasja pjesëmarrëse konfirmon se masat e përcaktuara në këtë dokument pasqyrojnë sfidat dhe aspiratat reale të sipërmarrësve tanë, duke u mbështetur në përvojën ndërkombëtare dhe kornizën zhvilluese të politikave të BE-së.

Prioritetet kryesore të Strategjisë përfshijnë:

- Ekosistem sipërmarrës konkurrues kombëtar;
- Qasje në financa;
- Tranzicioni i gjelbër dhe dixhital.

Fokusi është në lehtësimin e qasjes në financa për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, mbështetjen e inovacionit, hulumtimin dhe transformimin dixhital, nxitjen e sipërmarrjes dhe zhvillimin e aftësive, forcimin e potencialit të eksportit dhe ndërkombëtarizimit, si dhe promovimin e tranzicionit të gjelbër dhe ekonomisë qarkulluese. Këto prioritetet i përgjigjen sfidave më të mëdha në ditët e sotme – sic janë ndryshimet klimatike, dixhitalizimi dhe konkurrenca në tregjet globale, dhe ne nderkohe përgadisim ekonominë tonë për mundësitë në të ardhmen.

Ministria e Ekonomisë dhe Punës, si institucioni përgjegjës, do të udhëheqë dhe koordinojë zbatimin e kësaj Strategjie. Megjithatë, zbatimi i suksesshëm do të varet nga angazhimi aktiv dhe partneriteti i shumë

palëve të interesuara: Organet qeveritare, qeverisjet rajonale dhe lokale, institucionet financiare, shoqatat e biznesit, odat ekonomike, akademja dhe organizatat e shoqërisë civile. Në frymën e bashkëpunimit dhe përgjegjësis së përbashkët, ne përpiqemi të krijojmë një sinergji që do të rris ndikimin e masave të parashikuara.

Po aq i rëndësishëm është edhe angazhimi për monitorimin dhe vlerësimin e rregullt të Strategjisë. Duke vlerësuar sistematikisht progresin, duke identifikuar fushat për përmirësim dhe duke siguruar transparencë dhe llogaridhënie, ne do të jemi në gjendje të përshtasim politikat dhe të ruajmë ritmin e progresit në periudhën 2025–2030. Ky proces do të forcojë besimin midis institucioneve, bizneseve dhe qytetarëve dhe do të demonstrojë vendosmërinë tonë për t'i kthyer fjalët në rezultate.

Miratimi i Strategjisë për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme 2025–2030 shënon një hap vendimtar drejt ndërtimit të një ekonomie më të fortë, më konkurruese dhe më inovative. Ai gjithashtu pasqyron angazhimin tonë ndaj integritit evropian, pasi masat e përshkuara janë në përputhje me parimet dhe prioritetet e politikave të Bashkimit Evropian për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme. Duke i përafëruar përpjekjet tona kombëtare me standardet evropiane, ne po krijojmë themelet për rritjen e konkurrueshmërisë, përmirësimin të bashkëpunimit ndërkuftar dhe integrimin më të thellë në tregun e vetëm.

Dua të shpreh mirënjohjen time të sinqertë për të gjithë partnerët dhe palët e interesuara që kontribuan në përgatitjen e kësaj Strategjie. Ekspertiza, angazhimi dhe dialogu i tyre konstruktiv ishin thelbësore në formimin e një dokumenti që është njëkohësisht ambicioz dhe realist. Përmes një fryme të tillë bashkëpunimi, ne do të jemi në gjendje të sigurohemi që Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme të mbeten në zemër të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror.

Duke parë përpara, jam i bindur se zbatimi i Strategjisë së Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme 2025–2030 të Republikës së Maqedonisë së Veriut do të sjellë përmirësime të dukshme në mjedisin e biznesit, mundësi më të mëdha për sipërmarrësit tanë dhe përfitime më të qëndrueshme për shoqërinë tonë. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut mbetet plotësisht e përkushtuar për të mbështetur Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme, duke i njohur ato si një forcë lëvizëse për inovacion, krijimin e vendeve të punës dhe rritjen e qëndrueshme.

Le të ecim përpara së bashku me vendosshmëri, përgjegjësi dhe vizion, duke ndërtuar një sektor dinamik të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme që do të kontribuojë në prosperitetin dhe mirëqenien e qytetarëve tanë dhe do të forcojë rolin e Maqedonisë së Veriut brenda familjes evropiane.

**Besar Durmishi,**

Ministër i Ekonomisë dhe Punës i  
Republikës së Maqedonisë së Veriut



## Fjalim

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) janë shtylla e ekonomisë së vendit tonë. Ato përbëjnë shumicën e bizneseve aktive, kontribuojnë ndjeshëm drejt punësimit dhe luajnë një rol kyç në nxitjen e inovacionit, konkurrueshmërisë dhe rritjes ekonomike. Mbështetja e rritjes dhe zhvillimit të NVM-ve nuk është vetëm një përparësi ekonomike, por edhe një angazhim strategjik për zhvillimin afatgjatë dhe të qëndrueshëm të vendit tonë.

Strategjia e NVM-ve 2025-2030 ofron një kornizë të qartë për veprimin e politikave, në përputhje me prioritetet kombëtare për zhvillimin dhe integrimin e vendit në Bashkimin Evropian. Ajo është përshtatur me nevojat e vazhdueshme të NVM-ve për rritje dhe zhvillim, duke u përqendruar në fusha kyçe si janë: qasja në financat, transformi dixhital, kapaciteti për inovacion, zhvillimi i sipërmarrjes, potenciali për eksport dhe tranzicion të gjelbër. Fushat prioritare u përcaktuan përmes analizave të ekspertëve dhe dialogut ndërinstitucional, duke siguruar relevanc strategjike dhe zbatim praktik. Dokumenti gjithashtu pasqyron parimet e Aktit për bizneset e vogla të BE-së dhe objektivat më të gjera të politikave evropiane, duke i mundur ndërmarrjeve tona të pozicionohen më mirë në tregjet rajonale dhe evropiane.

Kjo Strategji është rezultat i një procesi gjithëpërfshirës dhe inkluziv. Si Kryetar i Grupit të Punës për Përgatitjen, Monitorimin dhe Zbatimin të Strategjisë, dua të shpreh mirënjohjen time të sinqertë deri tek të gjithë anëtarët e grupit të punës, përkushtimi dhe ekspertiza e të cilëve ishte thelbësore në përgatitjen e strategjis. Grupi përbëhej nga përfaqësues nga disa ministri, institucione dhe agjencione shtetërore, universitete, oda ekonomike dhe organizata të tjera relevante. Bashkëpunimi konstruktiv, profesionalizmi dhe përkushtimi mundësuan që Strategjia të jetë në përputhje me nevojat e NVM-ve, por edhe me politikat afatgjate kombëtare dhe të BE-së.

Përveç kësaj, dua të shpreh mirënjohje të veçantë për IBF Consulting, ekipi i së cilës me profesionalizëm të lart dhe ekspertizë të madhe e udhëheqi të gjithë procesin, duke siguruar mbështetje të vlefshme teknike dhe metodologjike në të gjitha fazat e zhvillimit të Strategjisë. Gjithashtu, dua të shpreh mirënjohjen time të veçantë për Delegacionin e Bashkimit Evropian në Maqedoninë e Veriut, i cili siguroi mbështetje financiare për përgatitjen e Strategjisë në kuadër të projektit " BE për zhvillimin e NVM-ve". Kontributi i tyre ishte thelbësor për të siguruar një qasje të strukturuar, të bazuar në prova dhe të harmonizuar ndërkombëtarisht.


Ministria e Ekonomisë dhe Punës do të mbështesë procesin e zbatimit dhe monitorimit të Strategjisë me të gjitha kapacitetet e saj, në bashkëpunim të vazhdueshëm me të gjitha institucionet dhe palët e interesuara.

Monitorimi, vlerësimi sistematik i rezultateve dhe indikatorëve të performancës të parashikuar në Planin e Veprimit dhe raportimit në lidhje me Strategjinë janë thelbësore për të siguruar zbatimin efikas të objektivave strategjike dhe për të vlerësuar ndikimin efektiv për zbatimin e saj. Monitorimi, vlerësimi dhe raportimi i rregullt do të sigurojnë llogaridhënie, do të mundësojnë përshtatje në kohë dhe do të ruajnë ritmin e progresit në periudhën 2025–2030.

Jam i bindur se zbatimi i kësaj Strategjie do të kontribuojë në ndërmarrje të vogla dhe të mesme të jenë më dinamike, inovative dhe konkurruese, duke krijuar mundësi të reja si për bizneset ashtu edhe për qytetarët. Përmes mbështetjes së koordinuar të politikave, angazhimit institucional dhe partneritetit me sektorin privat, do ti forcojmë themelet e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe do t'u mundësojmë ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme të vazhdojnë të nxisin rritjen dhe prosperitetin në vend.

**Jumni Ademi,**

Sekretar Shtetëror në Ministrinë e Ekonomisë dhe Punës  
Kryetar i Grupit të Punës për Përgatitjen dhe  
Monitorimin e Zbatimit të Strategjise 2025-2030



## Përmbajtja

Përmbajtja .....	7
Tabela e Akronimeve .....	8
1. Hyrje .....	9
Përmbledhje Ekzekutive .....	9
Sfondi .....	10
2. Përshtatja e Strategjisë me kornizat e politikave të BE-së, rajonale dhe kombëtare.....	12
2.1 Përmbledhje e kornizës së politikave të BE-së .....	12
2.2. Përmbledhje e Kornizave të Politikave për Ballkanin Perëndimor .....	19
2.3. Përmbledhje e Kornizës së Politikave Kombëtare .....	21
3. Qasja metodologjike .....	30
3.1. Metodologjia e përdorur.....	30
3.2 Përfshirja e palëve të interesit në procesin e hartimit të politikave .....	32
4. Analiza e situatës aktuale në sektorin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.....	33
4.1. Analiza e Sektorit të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme .....	33
4.2. Analiza SWOT dhe Analiza e Palëve të Interesuara .....	41
4.3. Vlerësimi i Strategjisë së mëparshme të NVM-ve dhe një përmbledhje e vlerësimeve të tjera ndërkombëtare .....	44
5. Korniza e politikave strategjike .....	51
5.1. Vizioni dhe Misioni i Strategjisë Kombëtare për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme 2025-2030 .	51
5.2. Fushat prioritare të Strategjisë Kombëtare të NVM-ve 2025-2030.....	51
Prioriteti #1: Ekosistemi Konkurrues Kombëtar Sipërmarrës .....	53
Prioriteti #2: Qasja në Financa.....	67
Prioriteti #3: Tranzicioni i Gjellbër dhe Dixhital .....	73
6. Korniza për Monitorim, Vlerësim dhe Raportim.....	78
6.1. Mekanizmat për Zbatimin e Strategjisë .....	79
6.1.1. Autoritetet Kompetente Përgjegjëse për Zbatimin, Monitorimit, Vlersimit dhe Raportimit ...	79
6.1.2. Procedura dhe Dinamika e Raportimit dhe Vlerësimit të Rezultateve të Arritura – Korniza e Monitorimit dhe Vlerësimit dhe raportimit për Strategjinë .....	81
6.2. Treguesit kryesorë dhe indikatorë të cilat e tregojnë suksesin e zbatimit të masave dhe aktiviteve të strategjisë së NVM-ve 2025-2030.....	83
8. Referencat .....	91
Shtojca 1 – Plani i veprimit .....	93

## Tabela e Akronimeve

BDS	Shërbime Zhvillimi Biznesi
KE	Komisioni Evropian
EN	Rrjeti i Ndërmarrjeve Evropiane
BE	Bashkimi Evropian
BPB-ja	Bruto Produkti i Brendshëm
GEM	Monitori Global i Ndërmarrësisë
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK)
INOVA	Agjencia për inovacion, zhvillim shkencor dhe teknologjik dhe sipërmarrje
IPO	Oferta Publike Fillestare
MTD	Ministria e Transformimit Dixhital
MEL	Ministria e Ekonomisë dhe Punës
MVR	Monitorimi, Vlerësimi dhe Raportimi
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
NVM	Ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme
OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
RIA	Vlerësimi i Ndikimit Rregullator
RMN	Republika e Maqedonisë së Veriut
NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
SWOT	Pikat e forta, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet
VET	Arsimi dhe trajnimi profesional
WBIF	Korniza e Investimeve në Ballkanin Perëndimor

# 1. Hyrje

## Përmbledhje Ekzekutive

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) është shtylla mbajtëse e çdo ekonomie. Ato janë punëdhënësit më të mdhenj dhe kontribuojnë ndjeshëm në Bruto Prodhimin e Brendshëm (BPB). NVM-të shpesh janë vende të inovacionit dhe ideve të reja biznesi, dhe ato inkurajojnë aktivitetin sipërmarrës, duke nxitur kreativitetin dhe konkurrencën në treg. Fleksibiliteti i tyre i lejon ato të përshtaten më lehtë me kushtet e tregut krahasuar me ndërmarrjet e mëdha. Ky sektor përfshin grupe të ndryshme të synuara, duke përfshirë gratë dhe të rinjtë, duke njohur idetë e tyre, duke ofruar mundësi punësimi dhe duke promovuar sipërmarrjen duke promovuar rritjen gjithëpërfshirëse.

Situata e sektorit të NVM-ve në Republikën e Maqedonisë së Veriut (RMV) nuk ndryshon ndjeshëm nga ajo në vendet e tjera. Në vitin 2023, ky sektor përbënte 99.7% të numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve dhe punësonte gati 75% të numrit të përgjithshëm të të punësuarve. NVM-të janë të pranishme në të gjithë sektorët dhe industritë, duke u përballur vazhdimisht me konkurrencën, trendet e tregut dhe nevojat dhe preferencat e klientëve, si dhe sfida të tjera që rrjedhin nga operacionet e tyre.

Mbështetja për zhvillimin e sektorit të NVM-ve ka qenë gjithashtu një përparësi e çdo qeverie që nga pavarësia e vendit. Kjo u confirmua nga miratimi i kornizave të mëparshme të politikave për NVM-të, të cilat ofruan udhëzime dhe vendosën qëllimet që kontribuan në zhvillimin e mëtejshëm të këtij sektori. Ky dokument është një vazhdim i përpjekjeve të Qeverisë për të mbështetur sektorin e NVM-ve duke zbatuar veprime dhe masa konkrete të përkthyer në një kornizë politikash që përcakton vizionin dhe qëllimet që duhen arritur në gjashtë vitet e ardhshme.

Në hartimin e këtij dokumenti, u morën në konsideratë edhe mësimet e nxjerra dhe përvoja nga zbatimi i strategjisë së mëparshme për NVM-të, së bashku me kontributin e anëtarëve të grupit të punës të ngritur nga Ministria e Ekonomisë dhe Punës (MEP) për të mbështetur hartimin e kësaj strategjie, si dhe sygjerimet e marra nga palët e tjera të interesit. Ky dokument është në përputhje jo vetëm me nevojat e NVM-ve, por edhe me prioritetet e politikave të Bashkimit Evropian (BE), Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) dhe kornizave strategjike kombëtare.

Prioritetet strategjike ndahen në tre shtylla kryesore që përcaktojnë ekosistemin në të cilin ndërmarrjet duhet të forcojnë më tej konkurrueshmërinë, produktivitetin dhe inovacionin e tyre duke krijuar një mjedis sipërmarrës që mbështet zhvillimin e NVM-ve, aksesin e NVM-ve në financim që duhet të përshpejtojë procesin e zhvillimit të tyre dhe një kornizë që promovon përdorimin e teknologjive të gjelbra dhe dixhitale.

Si një kornizë e politikave kombëtare, zbatimi i kësaj strategjie duhet të jetë përgjegjësi e të gjithë palëve të interesuara të përfshira në ekosistemin e mbështetjes dhe zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Strategjia shoqërohet nga një plan veprimi që përcakton masa dhe aktivitete specifike që do të çojnë në arritjen e qëllimeve dhe objektivave të përcaktuara.

## Sfondi

Strategjia e parë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në Republikën e Maqedonisë së Veriut u zhvillua në vitin 2002. Kjo ishte periudha kur Qeveria nënshkroi Memorandumin e Bashkëpunimit me Komisionin Evropian (KE) për pjesëmarrje në kuadër të Hartës Evropiane për Ndërmarrjet e Vogla<sup>1</sup>. Kjo strategji u shoqërua me një plan/program veprimi që përcaktonte masa dhe aktivitete për të promovuar sipërmarrjen dhe për të rritur konkurrencën e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme për periudhën 2002-2006.

Në vitin 2006, Strategjia për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM) u rishikua për të kontribuar në një rritje të përgjithshme të punësimit në sektorin e NVM-ve dhe për një kontribut më të madh në BPB. Ky rishikim kishte për qëllim të adresonte sfidat e reja dhe të vazhdueshme në sektorin e NVM-ve, duke përfshirë nevojën për përafrim me kërkesat e *Acquis Communautaire*, veçanërisht ato që lidhen me NVM-të. Përveç kësaj, ndryshimet u përqendruan në çështje të tilla si sipërmarrja, inovacioni dhe teknologjia e informacionit dhe komunikimit (TIK), të cilat ishin tipare kryesore të Programit Kornizë të Konkurrueshmërisë dhe Inovacionit të BE-së (2007–2013).

Edhe pse nuk kishte një kuadër specifik strategjik për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në periudhën 2013-2017, Qeveria vazhdoi ta mbështeste këtë sektor përmes zbatimit të masave dhe aktiviteteve të përcaktuara brenda programeve vjetore të institucioneve përkatëse.

Në vitin 2017, u përgatit një Strategji e re për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM), që mbulon periudhën 2018–2023. Ajo u zhvillua bazuar në rezultatet e strategjisë së mëparshme dhe prioritetet e Qeverisë, duke marrë gjithashtu parasysh kornizat dhe objektivat e politikave të BE-së. Kjo strategji përcaktoi prioritetet për përmirësimin e mjedisit të biznesit për zhvillimin e NVM-ve, duke forcuar njëkohësisht përpjekjet për të rritur konkurrueshmërinë dhe inovacionin. Strategjia u zhvillua me fokus në tre objektiva strategjike, rreth të cilëve u formuluan tre shtylla, duke shërbyer si bazë për organizimin e ndërhyrjeve specifike të programit.

- Objektivi Strategjik 1 - Të krijojë një mjedis të favorshëm biznesi që nxit sipërmarrjen dhe investimet.
- Objektivi Strategjik 2 - Të mbështeten ndërmarrjet e vogla dhe të mesme që të bëhen pjesëmarrëse shumë produktive dhe konkurruese në tregjet evropiane dhe ndërkombëtare.
- Objektivi Strategjik 3 - Të përmirësojë konkurrueshmërinë ekonomike të vendit duke rritur kapacitetin sipërmarrës dhe inovativ të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Një vlerësim i kohëve të fundit ka treguar se për shkak të disa faktorëve që ndikuan në zbatimin e Strategjisë së mëparshme (si mungesa e burimeve të mjaftueshme teknike dhe financiare, pandemia COVID-19, kriza energjitike dhe lufta në Ukrainë), zbatimi i Strategjisë, si dhe arritja e objektivave dhe synimeve të saj, nuk u realizuan plotësisht. Për shkak të kësaj, dhe meqenëse vlefshmëria e strategjisë së mëparshme ka skaduar, së bashku me trendet dhe prioritetet e reja globale të qeverisë së re, ka lindur nevoja për përgatitjen e një dokumenti të ri politikash.

---

<sup>1</sup><https://eur-lex.europa.eu/EN/legal-content/summary/european-charter-for-small-enterprises.html>

Strategjia e re për NVM -të 2025-2030 është një vazhdim i përpjekjeve të mëparshme për të mbështetur sektorin e NVM-ve në vend duke sfiduar prioritetet dhe duke zbatuar aktivitete që do të kontribuojnë më tej në rritjen e përpjekjeve të tyre për konkurrueshmëri dhe inovacion. Bazuar në këtë, Ministria e Ekonomisë dhe Punës ( MEN ) u ngarkua nga Qeveria për të zhvilluar Strategjinë e re për NVM-të për periudhën 2025-2030 dhe për të ngritur një grup pune me përfaqësues nga institucionet dhe organizatat përkatëse për të kontribuar në përgatitjen e këtij dokumenti. Për ta arritur këtë, MEN dhe grupi i punës u mbështetën nga Delegacioni i BE-së në RMV duke ofruar ekspertizë teknike për zhvillimin e strategjisë së re për NVM-të.

## 2. Përshtatja e Strategjisë me kornizat e politikave të BE-së, rajonale dhe kombëtare

Gjatë përgatitjes së këtij dokumenti të politikave, u analizua kuadri i politikave të BE-së për NVM-të për të harmonizuar prioritetet kryesore në zhvillimin e sektorit të NVM-ve të vendit në përputhje me kuadrin aktual të politikave të BE-së dhe kërkesat e Kapitullit 20 - *Politika e ndërmarrjeve dhe industrisë*. Në këtë kontekst, u shqyrtuan dokumentet strategjike të BE-së që përqendrohen në politikat e NVM-ve, si dhe dokumente të tjera të lidhura me politikat rajonale (në kontekstin e Ballkanit Perëndimor (BP)).

RMV është plotësisht e përkushtuar ndaj zbatimit të kriterëve ekonomike dhe politike të BE-së, duke përfshirë fushën e zhvillimit industrial dhe politikës së NVM-ve. Është e nevojshme të theksohet se në zbatimin e parimeve të BE-së dhe hartimin dhe zbatimin e politikës së NVM-ve, RMV ka miratuar Hartën Evropiane për Ndërmarrjet e Vogla si një udhëzues për zhvillimin e mëtejshëm të sektorit të NVM-ve. Ky proces vazhdoi me transformimin e Hartës dhe miratimin e Aktit të Biznesit të Vogël (SBA) si një parim udhëzues, së bashku me vendet e tjera në BP dhe Turqinë.

### 2.1 Përmbledhje e kornizës së politikave të BE-së

Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM) evropiane kanë kaluar nëpër sfida të rëndësishme gjatë viteve të fundit, pas një pandemie të paparë dhe ndërprerjeve globale të zinxhirit të furnizimit gjatë epokës pas pandemisë, duke rrezikuar rimëkëmbjen ekonomike të NVM-ve të BE-së. Strategjia e re Industriale Evropiane, e orientuar drejt tranzicionit të dyfishtë në një ekonomi të gjelbër dhe dixhitale, përcakton mundësi për NVM-të që meritojnë vëmendje të veçantë. Përveç kësaj, Autonomia Strategjike e Hapur, si një paradigmë e re politike e Bashkimit Evropian, synon të sigurojë që Bashkimi të mund të ndjekë interesat dhe vlerat e tij në mënyrë të pavarur, duke mbetur i hapur ndaj bashkëpunimit global.

Sipas Raportit Vjetor 2023/2024 mbi NVM-të Evropiane - Rishikimi i Performancës <sup>2</sup>, NVM-të në BE kanë demonstruar aktivitet të konsiderueshëm në zbatimin e veprimeve inovative brenda zinxhirëve kritikë të vlerës. Pavarësisht këtij momenti dhe iniciativave të shumta që mbështesin kërkimin dhe zhvillimin (R&D) dhe inovacionin, produktiviteti i NVM-ve tregon se ka ende hapësirë për përpjekje të mëtejshme, të cilat mund të arrihen duke ofruar mbështetje shtesë dhe duke përcaktuar korniza të përshtatshme politike. Nëse fokusi vendoset në zinxhirët kritikë të vlerës, NVM-të duket se luajnë një rol kyç, veçanërisht në prodhimin e specializuar dhe zhvillimin e tregjeve të reja, siç është riciklimi i lëndëve të para nga mbeturinat. Produktiviteti është gjithashtu një faktor vendimtar për NVM-të, i cili mund të paraqesë rreziqe specifike në kontekstin e Autonomisë së Hapur Strategjike, që synon promovimin e prodhimit vendas të BE-së dhe

---

<sup>2</sup> [https://single-market-economy.ec.europa.eu/document/download/2bef0eda-2f75-497d-982e-c0d1cea57c0e\\_en?filename=Annual%20Report%20on%20European%20SMEs%202024.pdf](https://single-market-economy.ec.europa.eu/document/download/2bef0eda-2f75-497d-982e-c0d1cea57c0e_en?filename=Annual%20Report%20on%20European%20SMEs%202024.pdf)

inovacionit në produkte dhe teknologji kritike. Është me rëndësi jetike që politikëbërësit t'i njohin NVM-të si katalizatorë të transformimit që Evropa ka nevojë urgjente dhe t'i shndërrojë ato nga ndjekës në udhëheqës të ndryshimeve rrënjësore, duke i vendosur ato në thelb të hartimit të politikave të BE-së.

### *Axhenda e Gjelbër e BE-së*

Dokumenti strategjik i BE-së, **Marrëveshja e Gjelbër Evropiane**<sup>3</sup>, është një strategji e re rritjeje që synon transformimin e BE-së në një shoqëri të drejtë dhe të begatë, me një ekonomi moderne, efikase dhe konkurruese. Ai ofron një udhërrëfyes për të krijuar kushte për një ekonomi të qëndrueshme brenda BE-së duke i kthyer sfidat klimatike dhe mjedisore në mundësi në të gjitha fushat e politikave, duke siguruar një tranzicion të drejtë dhe gjithëpërfshirës për të gjithë. Kalimi në një ekonomi të gjelbër ka një ndikim të rëndësishëm në tregun e punës, duke ndryshuar kërkesën e përgjithshme për aftësi, veçanërisht në sektorët që do të duhet t'i nënshtrohen ristrukturimit të thellë të shkaktuar nga përdorimi i teknologjive më të gjelbra, proceseve të qëndrueshme të prodhimit dhe modeleve të biznesit. Ai gjithashtu përfaqëson një kornizë për formulimin e politikave të NVM-ve dhe kalimin e tyre drejt zhvillimit të qëndrueshëm. Marrëveshja e Gjelbër Evropiane është një udhërrëfyes veprimesh për të forcuar përdorimin efikas të burimeve duke lëvizur drejt një ekonomie të pastër dhe rrethore, duke ndaluar ndryshimet klimatike, duke përmbysur humbjen e biodiversitetit dhe duke zvogëluar ndotjen. Ai përshkruan investimet e nevojshme dhe mjetet e disponueshme të financimit dhe shpjegon se si të sigurohet një tranzicion i drejtë dhe gjithëpërfshirës.

Në shkurt të vitit 2023, BE-ja miratoi **Planin Industrial për Marrëveshjen e Gjelbër për Epokën Zero të Energjisë Elektrike**.<sup>4</sup> i cili përfaqëson një kornizë të BE-së "që rrjedh nga nevoja për një ngritje masive në zhvillimin e teknologjisë, prodhimin dhe instalimin e produkteve me emetim zero neto dhe furnizimin me energji, duke njohur konkurrencën për lëndë të para dhe punë të kualifikuar". Plani i ri Industrial synon të përmirësojë kornizën që mbështet tranzicionin e modeleve të biznesit bazuar në një mjedis rregullator të parashikueshëm dhe të thjeshtuar, qasje më të shpejtë në financim të mjaftueshëm, aftësi të forcuar dhe mbështetje për tregti të hapur për zinxhirë furnizimi elastikë. Marrëveshja e Gjelbër është një pjesë integrale e strategjisë së Komisionit Evropian për të zbatuar Axhendën 2030 të Kombeve të Bashkuara dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.

### *Politika Industriale e BE-së*

Si plotësim i kuadrit të politikave të NVM-ve, duhet përmendur edhe politika industriale e BE-së, e cila përqendrohet në përmirësimin e mjedisit të biznesit dhe mbështetjen e konkurrueshmërisë dhe rritjes. Objektivi i **Strategjisë së re Industriale për Evropën**<sup>5</sup> është të mbështesë tranzicionet e dyfishta, ta bëjë industrinë e BE-së globalisht konkurruese dhe të forcojë autonominë strategjike

<sup>3</sup>COM(2019) 640 final, <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=CELEX:52019DC0640>

<sup>4</sup>COM(2023) 62 final, <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52023DC0062>

<sup>5</sup>COM/2020/102, <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52020DC0102>

të Evropës, me qëllim transformimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të industrive tradicionale dhe të reja, mbështetjen e NVM-ve dhe promovimin e qëndrueshmërisë konkurruese në të gjithë BE-në. Kohëve të fundit, aktivitetet e reja të mbështetjes së inovacionit të BE-së janë përqendruar në zhvillimin e distrikteve të inovacionit për teknologjitë e bazuara në zbulime të rëndësishme shkencore ose përparime inxhinierike (të ashtuquajturat teknologji të thella “deep tech”). Distriktet e inovacionit janë qendra dinamike ku akademia, industria dhe qeveria bashkohen për të nxitur zbulime shkencore, komercializim dhe sipërmarrje. Këto lugina veprojnë si katalizatorë për rritjen rajonale, duke tërhequr talente, kompani dhe investime ndërkombëtare <sup>6</sup>. Në vitin 2021, Komisioni Evropian përditësoi politikën industriale të BE-së - **Strategjia Industriale 2020: Drejt një Tregu të Vetëm më të Fortë për Rimëkëmbjen e Evropës** <sup>7</sup>, e cila riafirmoi prioritetet e përcaktuara në vitin 2020. Brenda kësaj Strategjie, propozohen masa të reja për të forcuar qëndrueshmërinë e tregut të vetëm të BE-së, veçanërisht në kohë krize. Ai trajton nevojën për një kuptim më të mirë të ndërvarësive në fushat kryesore strategjike dhe përfaqëson një kuti mjetesh për adresimin e tyre. Ofron masa të reja për të përshpejtuar tranzicionin e gjelbër dhe dixhital. Strategjia e përditësuar gjithashtu i përgjigjet thirrjeve për të identifikuar dhe monitoruar treguesit kryesorë të konkurrueshmërisë ekonomike të BE-së në përgjithësi: integrimin e tregut të vetëm, rritjen e produktivitetit, konkurrueshmërinë ndërkombëtare, investimet publike dhe private, si dhe investimet në kërkim-zhvillim. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme janë si bazë e strategjisë së përditësuar, me mbështetje financiare të përshtatura dhe masa për t'u mundësuar si ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme ashtu edhe startup-eve të përqafojnë tranzicionin e dyfishtë.

### ***Politika e BE-së për NVM-të***

Në fushën e politikës së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, gjatë dekadës së fundit, BE-ja ka miratuar disa dokumente strategjike që krijuan kushte specifike për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, me qëllim rritjen e inovacionit dhe konkurrueshmërisë midis ndërmarrjeve.

**Strategjia e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme për një Evropë të Qëndrueshme dhe Dixhitale**<sup>8</sup> E miratuar në mars të vitit 2020, mbështetet në themelet e forta të kuadrit të politikave të NVM-ve dhe programeve mbështetëse të BE-së, duke iu referuar kryesisht SBA-së për Evropën <sup>9</sup>. Strategjia synon të zhbllokojë potencialin e SME-ve evropiane për të udhëhequr tranzicionet e dyfishta drejt qëndrueshmërisë dhe dixhitalizimit. Një përparësi kryesore e Strategjisë është të mundësojë një rritje të konsiderueshme të numrit të SME-ve me rritje të lartë dhe numrit të SME-ve që përdorin teknologji dixhitale. Strategjia përfaqëson vazhdimësi dhe mbështetet në arritjet e SBA-së dhe prioritetet e saj.

Qëllimi kryesor i politikave të BE-së të përcaktuara nga *Strategjia e NVM-ve për një Evropë të Qëndrueshme dhe Dixhitale* është të stimulojë potencialin e të gjitha NVM-ve në BE në mënyrë

<sup>6</sup> <https://innovationdistrictcopenhagen.dk/> ( Shembull i një distrikti inovacioni të themeluar në pranverën e vitit 2024 )

<sup>7</sup> COM (2021) 350/2, [https://commission.europa.eu/document/download/9ab0244c-6ca3-4b11-bef9-422c7eb34f39\\_en?filename=communication-industrial-strategy-update-2020\\_en.pdf](https://commission.europa.eu/document/download/9ab0244c-6ca3-4b11-bef9-422c7eb34f39_en?filename=communication-industrial-strategy-update-2020_en.pdf)

<sup>8</sup> COM/2020/103; <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52020DC0103>

<sup>9</sup> [https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/fr/memo\\_11\\_109](https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/fr/memo_11_109)

që ato të mund të udhëheqin tranzicionin e dyfishtë të ekonomisë (drejt qëndrueshmërisë dhe dixhitalizimit), me një rritje të konsiderueshme të numrit të NVM-ve me rritje të lartë përmes përdorimit të teknologjive dixhitale. Prioritetet e SBA-së brenda Strategjisë u reformësuan në tre shtylla dhe fusha kryesore ndërhyrjeje, të cilat paraqiten si më poshtë:

- Ndërtimi i kapaciteteve dhe mbështetja e tranzicionit drejt qëndrueshmërisë dhe dixhitalizimit
- Ulja e barrës rregullatore dhe përmirësimi i aksesit në treg
- Përmirësimi i aksesit në financa

Nga ana tjetër, **SBA për Evropën**<sup>10</sup>, e cila është dokumenti kryesor strategjik i BE-së, pasqyron vullnetin politik të Komisionit për të njohur rolin qendror të NVM-ve në ekonominë e BE-së dhe për herë të parë krijon një kornizë gjithëpërfshirëse të politikave të NVM-ve që BE-ja dhe Shtetet Anëtare të saj mund ta përdorin për të hartuar politikat e NVM-ve. Ajo u miratua në vitin 2008 dhe synon të përmirësojë qasjen e përgjithshme ndaj sipërmarrjes, të ngulisë përgjithmonë parimin "Fillimisht mendo për të voglit" në hartimin e politikave, nga rregullimi deri te ofrimi i shërbimeve publike, dhe të mbështesë rritjen e NVM-ve duke ndihmuar në trajtimin e problemeve të mbetura që pengojnë zhvillimin e tyre.

Prioritetet kryesore të Aktit lidhen me promovimin e sipërmarrjes, përmirësimin e aksesit në financa, uljen e barrës rregullatore dhe përmirësimin e aksesit në treg dhe ndërkombëtarizimin. Këto parime janë me rëndësi themelore për të shtuar vlerë në nivel të BE-së, për të krijuar një fushë loje të barabartë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe për të përmirësuar mjedisin ligjor dhe administrativ në BE. Këto prioritete janë përcaktuar në 10 parime të hartuara për të mbështetur krijimin dhe zbatimin e politikave si në nivel të BE-së ashtu edhe në nivel kombëtar .

### ***Instrumentet Financiare të BE-së***

Në periudhën buxhetore 2021-2027, BE-ja ripërcaktoi gjithashtu programet për të zbatuar politika të ndryshme në kuadër të **Rregullores së Dispozitive të Përbashkëta 2021-2027**<sup>11</sup>. Bazuar në këtë dokument, Shtetet Anëtare zhvilluan strategji investimi në nivel kombëtar dhe rajonal, të cilat përcaktojnë instrumentet financiare të përdorura në programet e mbështetjes së NVM-ve. Programet e BE-së janë gjithashtu të arritshme për vendet kandidatë dhe vendet e tani më të bashkangjitura drejt BE-së, në përputhje me kushtet e përcaktuara në rregulloret që përcaktojnë programin.

**Programi i Tregut të Vetëm**<sup>12</sup> përqendrohet në forcimin e qeverisjes së tregut të brendshëm, duke mbështetur konkurrueshmërinë industriale - veçanërisht për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të

<sup>10</sup> {SEC(2008) 2101} {SEC(2008) 2102}, <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52008DC0394>

<sup>11</sup> <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32021R1060&from=EN>

<sup>12</sup> [https://commission.europa.eu/funding-tenders/find-funding/eu-funding-programmes/single-market-programme\\_en](https://commission.europa.eu/funding-tenders/find-funding/eu-funding-programmes/single-market-programme_en)

mesme (NMVM) - duke mbrojtur shëndetin e njerëzve, kafshëve dhe bimëve, dhe duke siguruar mirëqenien e kafshëve, si dhe duke krijuar një kornizë financimi për statistikat evropiane. Fusha specifike e ndërhyrjeve të programit përfshin rritjen e konkurrueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së NMV-ve, mbështetjen e standardizimit evropian dhe forcimin e Unionit të Konsumatorëve.

**Shtylla e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM)** <sup>13</sup> e Programit i Tregut të Përbashkët siguron vazhdimësi në zbatimin e aktiviteteve më me ndikim nga Programi COSME, veçanërisht duke mbështetur akses më të mirë në tregje, një mjedis më të favorshëm biznesi dhe promovimin e sipërmarrjes. Synon të nxisë konkurrueshmërinë, ndërtimin e kapaciteteve dhe qëndrueshmërinë e ndërmarrjeve - veçanërisht midis ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM).

Programet kryesore përfshijnë:

- **Erasmus për Sipërmarrësit e Rinj** <sup>14</sup> - mbështetja e sipërmarrjes dhe aksesit në aftësi,
- **Rrjeti Evropian i Ndërmarrjeve (EEN)** <sup>15</sup> - një qendër e vetme që ndihmon ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të rrisin konkurrueshmërinë e tyre dhe të rrisin bizneset e tyre në Tregun e Përbashkët dhe më gjerë, duke përfshirë rajonet më të largëta të BE-së.
- **Iniciativa e Përbashkët e Klusterave** <sup>16</sup> - që synon lidhjen e ekosistemeve të specializuara industriale për të krijuar mundësi të reja biznesi për NVM-të dhe për t'i integruar ato më mirë në zinxhirët strategjikë të vlerave evropiane dhe globale.

Mbështetja për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme ekziston dhe është e zbatueshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut: ajo zbatohet në përputhje me hapat e vendit tonë në procesin e anëtarësimit në BE. Pjesëmarrja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme lokale në këto aktivitete do të kontribuojë në krijimin e vendeve të punës dhe rritjen duke forcuar konkurrueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, duke mbështetur kështu rimëkëmbjen ekonomike.

**Shpesh herë NVM** përballen me nivel të lartë të pasiguris, kufizime në furnizim, mungesë të fuqisë punëtore dhe konkurrencë jo gjithmonë të drejtë. Paqëndrueshmëria dhe paparashikueshmëria e kontekstit aktual ekonomik e bëjnë më të vështirë bërjen e biznesit për NVM-të. Paketa e Ndhmës për NVM- (SME Relief Package) <sup>17</sup> propozon masa të reja që do të sigurojnë ofrimin e drejtësisë afatshkurte, forcimin e konkurrueshmërisë afatgjatë të NVM-ve dhe rritjen e drejtësisë në mjedisin e afarist rreth një Tregu të vetëm. Ndërhyrjet kryesore përfshijnë:

<sup>13</sup> [https://eisma.ec.europa.eu/programmes/single-market-programme/support-smes\\_en](https://eisma.ec.europa.eu/programmes/single-market-programme/support-smes_en)

<sup>14</sup> <https://www.erasmus-entrepreneurs.eu/>

<sup>15</sup> <https://een.ec.europa.eu/>

<sup>16</sup> <https://www.clustercollaboration.eu/>

<sup>17</sup> COM(2023) 535 final, [https://single-market-economy.ec.europa.eu/document/download/8b64cc33-b9d9-4a73-b470-8fae8a59dba5\\_en?filename=COM\\_2023\\_535\\_2023\\_535\\_1\\_1\\_EN](https://single-market-economy.ec.europa.eu/document/download/8b64cc33-b9d9-4a73-b470-8fae8a59dba5_en?filename=COM_2023_535_2023_535_1_1_EN)

- Rregullorja për pagesat e vonuara <sup>18</sup>,
- Direktiva mbi Thjeshtësimin e Taksave për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme <sup>19</sup>,
- Një sërë masash të ofruara për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme për të përmirësuar aksesin në financa dhe punë të kualifikuar, si dhe për të mbështetur ndërmarrjet e vogla dhe të mesme gjatë gjithë ciklit të tyre jetësor të biznesit.

Masa e re e propozuar **për parandalimin e vonesave në pagesat** <sup>20</sup> në transaksionet tregtare trajton vonesat në pagesa, një praktikë e padrejtë që rrezikon fluksin e parave të gatshme të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe minon konkurrueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e zinxhirëve të furnizimit. Rregullat e reja do të shfuqizojnë Direktivën e vitit 2011 për Vonesat në Pagesa dhe do ta zëvendësojnë atë me një kuadër rregullator. Propozimi prezanton një limit maksimal më të rreptë pagese prej 30 ditëve, eliminon paqartësitë dhe adreson boshllëqet ligjore të pranishme në Direktivën aktuale. Teksti i propozuar siguron gjithashtu pagesën automatike të interesit të grumbulluar dhe tarifave të kompensimit dhe prezanton masa të reja zbatimi dhe korrigjimi për të mbrojtur bizneset nga pagesit e vonuar.

Paralelisht, BE-ja po punon për një **plan të bashkimit të tregjeve të kapitalit** <sup>21</sup>, (**Capital markets union plan**) i cili përfaqëson një axhendë për krijimin e një tregu të vetëm kapitali që do ta bëjë më të lehtë për bizneset e vogla qasjen në fonde dhe do ta bëjë Evropën një vend më tërheqës për të investuar. Qëllimi është të mundësohet rrjedha e lirë e parave - investimeve dhe kursimeve - në të gjithë BE-në, në mënyrë që konsumatorët, investitorët dhe kompanitë të mund të përfitojnë pavarësisht nga vendndodhja e tyre. Megjithatë, tregjet e kapitalit të BE-së mbeten të fragmentuara. Plani përshkruan 16 masa legjislative dhe jo-legjislative për të arritur tre objektiva kryesore:

- Mbështetje një rimëkëmbje ekonomike të gjelbër, gjithëpërfshirëse dhe elastike,
- Ta bëhet BE-në një vend edhe më të sigurt për kursime dhe investime afatgjata, dhe
- Integrimi i tregjeve kombëtare të kapitalit në një treg vërtet të vetëm.

### **Strategjia Dixhitale e BE-së**

Qëllimi i këtij kuadri politikash është dixhitalizimi i lirive të Tregut të vetëm të BE-së duke përcaktuar rregulla për shërbimet e telekomunikacionit, të drejtën e autorit dhe mbrojtjen e të dhënave. **Strategjia Dixhitale e BE-së** <sup>22</sup> është përcaktuar **përmes një ndërhyrjeje specifike - Dekada Dixhitale 2030** <sup>23</sup> si një kornizë gjithëpërfshirëse që përfshin të gjitha aktivitetet

<sup>18</sup> <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52023PC0533> , COM(2023) 533 final/2,

<sup>19</sup> [https://taxation-customs.ec.europa.eu/taxation/business-taxation/head-office-tax-system-smes-hot\\_en](https://taxation-customs.ec.europa.eu/taxation/business-taxation/head-office-tax-system-smes-hot_en)

<sup>20</sup> [https://single-market-economy.ec.europa.eu/smes/challenges-and-resilience/late-payment\\_en](https://single-market-economy.ec.europa.eu/smes/challenges-and-resilience/late-payment_en)

<sup>21</sup> [https://finance.ec.europa.eu/capital-markets-union-and-financial-markets/capital-markets-union/what-capital-markets-union\\_en](https://finance.ec.europa.eu/capital-markets-union-and-financial-markets/capital-markets-union/what-capital-markets-union_en)

<sup>22</sup> <https://eufordigital.eu/discover-eu/eu-digital-strategy/>

<sup>23</sup> <https://digital-strategy.ec.europa.eu/en/policies/europes-digital-decade>

'dixhitale', duke përfshirë *Programin e Politikave të Dekadës Dixhitale*. Ky program politikash udhëhiqet nga **Busulla Dixhitale 2030**<sup>24</sup> - një udhërrëfyes për arritjen e transformimit dixhital të ekonomisë dhe shoqërisë së BE-së. Objektivat kryesore të Kornizës Dixhitale të BE-së përmbledhen në katër fusha kryesore:

- Një popullsi e aftë në fushën e dixhitalizimit dhe profesionistë dixhitalë shumë të kualifikuar;
- Infrastruktura dixhitale të sigurt dhe të qëndrueshme;
- Transformimi dixhital i bizneseve;
- Dixhitalizimi i shërbimeve publike.

### ***Rregullore më e mirë e BE-së***

**Axhenda për një rregullore më të mirë**<sup>25</sup> siguron legjislacion të BE-së transparent dhe të bazuar në prova, të bazuar në pikëpamjet e palëve të interesuara. Objektivat e saj janë të sigurojë që procesi i hartimit të politikave të BE-së të bazohet në prova, t'i bëjë ligjet e BE-së më të thjeshta dhe më të mira, dhe të shmangë barrën e panevojshme — duke përfshirë qytetarët, bizneset dhe palët e interesuara në vendimmarrje. Rregullorja më e mirë siguron hartimin e politikave më transparente dhe efikas. Që nga viti 2021, pikat kryesore të Axhendës së reviduar të Rregullores më të mirë përfshijnë:

- Konsultimet publike të sjellura si "Thirrje për Dëshmi" të vetme;
- Forcimi i përpjekjeve të Komisionit për të thjeshtësuar rregullat e BE-së dhe për të zvogëluar barrën e panevojshme, përmes REFIT<sup>26</sup> dhe qasjes "një brenda, një jashtë" (one in one out);
- Heqja e pengesave dhe burokracisë që ngadalësojnë investimet;
- Përmirësimi i mënyrës se si Axhenda e Rregullimit më të Mirë adreson dhe mbështet objektivat e qëndrueshmërisë.

**Testi i NVM-ve (SME test)**<sup>27</sup> analizon efektet e propozimeve të ardhshme legjislative të BE-së mbi NVM-të. Duke vlerësuar kostot dhe përfitimet e opsioneve të politikave për NVM-të, ai promovon parimin "Mendo së pari për të vegjlit" dhe kontribuon në përmirësimin e mjedisit të biznesit. Testi i NVM-ve është pjesë integrale e procesit të vlerësimit të ndikimit të rregullores së Komisionit Evropian. Testi i NVM-ve përbëhet nga:

- Identifikimi i bizneseve që ka më shumë gjasa të preken;
- Konsultimi i NVM-ve dhe organizatave përfaqësuese (siç janë palët e interesuara të NVM-ve dhe EEN);

<sup>24</sup> [https://eur-lex.europa.eu/resource.html?uri=cellar:12e835e2-81af-11eb-9ac9-01aa75ed71a1.0001.02/DOC\\_1&format=PDF](https://eur-lex.europa.eu/resource.html?uri=cellar:12e835e2-81af-11eb-9ac9-01aa75ed71a1.0001.02/DOC_1&format=PDF)

<sup>25</sup> [https://commission.europa.eu/law/law-making-process/planning-and-proposing-law/better-regulation\\_en#documents](https://commission.europa.eu/law/law-making-process/planning-and-proposing-law/better-regulation_en#documents)

<sup>26</sup> [https://commission.europa.eu/law/law-making-process/evaluating-and-improving-existing-laws/refit-making-eu-law-simpler-less-costly-and-future-proof\\_en](https://commission.europa.eu/law/law-making-process/evaluating-and-improving-existing-laws/refit-making-eu-law-simpler-less-costly-and-future-proof_en)

<sup>27</sup> [https://commission.europa.eu/law/law-making-process/planning-and-proposing-law/better-regulation\\_en#documents](https://commission.europa.eu/law/law-making-process/planning-and-proposing-law/better-regulation_en#documents)

- Vlerësimi i ndikimeve në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (analiza e kostos dhe përfitimit);
- Duke eksploruar opsionet e politikave për të minimizuar efektet negative mbi NVM-të ose duke marrë në konsideratë masat zbutëse, nëse është e nevojshme.

## 2.2. Përmbledhje e Kornizave të Politikave për Ballkanin Perëndimor

Gjatë dekadës së fundit, qeveritë e Ballkanit Perëndimor kanë miratuar gjithashtu disa axhenda politike që përcaktojnë prioritetet që duhen arritur në nivel rajonal. Këto janë prioritetet të ndërmjetme (pika referimi) që shtrihen diku midis prioritetëve të BE-së dhe atyre kombëtare.

Me nënshkrimin e Deklaratës në Sofje (në samitin e mbajtur në nëntor 2020), të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor mbështetën plotësisht parimet e **Axhendës së Gjelbër Evropiane për Ballkanin Perëndimor**.<sup>28</sup> dhe shprehën angazhimin e tyre për të zbatuar veprime konkrete brenda pesë shtyllave të mëposhtme të **Axhendës së Gjelbër Evropiane** :

- Dekarbonizimi: klima, energjia, lëvizshmëria
- Ekonomia qarkulluese: prodhim dhe konsum i qëndrueshëm
- Dendotja (pastrim): zvogëlimi i ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës:
- Sisteme të qëndrueshme ushqimore dhe zona rurale
- Biodiversiteti: mbrojtja dhe restaurimi i ekosistemeve

Për më tepër, dixhitalizimi duhet të shërbejë si një mundësi kyçe në arritjen e pesë shtyllave të përmendura më sipër, në përputhje me konceptin e tranzicionit dypalësh të gjelbër dhe atij dixhital. Objektivat e këtyre shtyllave duhet të ndiqen përmes veprimeve konkrete dhe të mbështeten nga mekanizma dhe instrumente specifike financiare.

Përveç prioritetëve të kuadrit rajonal, ekziston edhe **Strategjia 2030 e Evropës Juglindore**.<sup>29</sup> objektivi kryesor i të cilit është të promovojë dhe avancojë zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara përmes bashkëpunimit rajonal midis të gjitha ekonomive të Evropës Juglindore (EJL) në të tre dimensionet. Strategjia e EJL përfshin trembëdhjetë fusha prioritare të ndërhyrjes, duke ofruar një kornizë për një qasje të integruar për adresimin e çështjeve të qëndrueshmërisë. Deri në vitin 2030, qëllimi i kësaj strategjie rajonale është të arrijë një rritje ekonomike të qëndrueshme rajonale që synon uljen e varfërisë dhe pabarazive, përmirësimin e përfshirjes sociale, fuqizimin e grave, ngadalësimin e depopullimit, përmirësimin e cilësisë së përgjithshme të jetës së qytetarëve dhe përshpejtimin e tranzicioneve të gjelbra dhe dixhitale pa kompromentuar konkurrueshmërinë dhe zhvillimin e sektorit privat.

<sup>28</sup>{COM(2020) 641 final}, [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2020-10/green\\_agenda\\_for\\_the\\_western\\_balkans\\_en.pdf](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2020-10/green_agenda_for_the_western_balkans_en.pdf)

<sup>29</sup><https://www.rcc.int/pages/148/south-east-europe-sec2030-strategy>

Një dokument tjetër i rëndësishëm është **Plani i Veprimit për Tregun e Përbashkët Rajonal 2025–2028**,<sup>30</sup> i cili përfaqëson një kornizë të drejtuar nga rajoni, bazuar në rregullat dhe standardet e BE-së, që synon konsolidimin dhe rritjen e konkurrueshmërisë dhe bashkëpunimit ekonomik. Ky Plan Veprimi është një pjesë integrale e **Planit të Rritjes për Ballkanin Perëndimor**, i cili synon të stimulojë rritjen ekonomike dhe të rrisë konvergencën socio-ekonomike të rajonit, duke e sjellë atë më afër Tregut të Përbashkët të BE-së.

Fushat kryesore e mbuluara nga Tregu i Përbashkët Rajonal 2.0 përfshijnë: lëvizjen e lirë të mallrave, lëvizjen e lirë të shërbimeve, masat tregtare horizontale, zhvillimin e kapitalit njerëzor, një mjedis të favorshëm biznesi dhe konkurrueshmëri, si dhe transformimin dixhital.

Ndikimi pozitiv në PBB-në dhe nivelet e të ardhurave në vendet e Ballkanit Perëndimor që rezultojnë nga integrimi me Tregun e Përbashkët të BE-së — në kombinim me Politikën e Kohezionit të BE-së — është demonstruar qartë në të kaluarën. Mësimet e nxjerra tregojnë se rritja e mëtejshme kërkon investime në modernizimin e ekonomive dhe infrastrukturës, gjë që kërkon mbështetje shtesë financiare. **Plani i ri i Rritjes për Ballkanin Perëndimor**<sup>31</sup> synon të integrojë ekonominë e rajonit në Tregun e Përbashkët të BE-së, të rrisë bashkëpunimin ekonomik rajonal, të thellojë reformat e lidhura me BE-në dhe të rrisë fondet para-anëtarësimit për të përshpejtuar konvergencën socio-ekonomike të Ballkanit Perëndimor me BE-në. Ky Plan i ri i Rritjes ndërtohet mbi metodologjinë ekzistuese të zgjerimit dhe krijon masa që përforcojnë reciprocisht që do të shumëfishojnë përfitimet e mundshme të secilit veprim individual. Plani i Rritjes është strukturuar rreth katër shtyllave:

- Përmirësimi i integritetit ekonomik me Tregun e Përbashkët të BE-së
- Forcimi i integritetit ekonomik midis vendeve të Ballkanit Perëndimor përmes një Tregu të Përbashkët Rajonal
- Përshpejtimi i reformave themelore
- Mbështetja e konvergencës përmes rritjes së ndihmës financiare.

Portali Kombëtar i Mbështetjes së Biznesit duhet të shërbejë si një platformë e vetme për të lehtësuar rritjen e biznesit, pajtueshmërinë rregullatore dhe aksesin në financim, arsim dhe mundësi rrjetëzimi. Duke ofruar një gamë të gjerë të informacioneve, portali mund të bëhet një aset thelbësor për sipërmarrësit dhe bizneset e vogla. Në këtë kontekst, ky portal duhet të ofrojë lloje të ndryshme informacioneve në lidhje me qasjen në financa dhe mekanizma të ndryshëm ndërkombëtarë dhe vendase të financimit për NVM-të, lejet, licencat, informacionin mbi eksportin, shpjegimin e procedurave të ndryshme të kërkuara nga institucione të ndryshme shtetërore, kuadrin kryesor ligjor që lidhet me NVM-të, informacionin mbi masat jo-tarifore, informacionin mbi organizatat mbështetëse të biznesit dhe mbështetjen/shërbimet që ato ofrojnë, si dhe informacione të tjera relevante në interes të NVM-ve <sup>67</sup>.

Përveç kësaj, duhet të hartohet edhe një platformë specifike që do të ofrojë informacione në lidhje me eksportin për ato ndërmarrje që dëshirojnë të ndërkombëtarizojnë aktivitetet e tyre, siç janë informacioni mbi masa të ndryshme tarifore dhe jo-tarifore (p.sh., baza e të dhënave TRAINS e

<sup>66</sup><https://scienceparkboras.se/>

<sup>67</sup>Tashmë ekzistonin portale të ngjashme si [www.konkurentnost.mk](http://www.konkurentnost.mk) dhe [www.biznisregulativa.mk](http://www.biznisregulativa.mk) që mbështeteshin nga donatorët, por problemi është qëndrueshmëria e portalit pas përfundimit të financimit të projektit.

UNCTAD <sup>68</sup>), informacioni mbi kuotat, masat e disponueshme të mbështetjes së eksportit, skema e garancisë së kreditit dhe informacione të tjera relevante . Kjo masë është në përputhje me rekomandimet nga vlerësimi i fundit i kryer brenda AMB (2022) në lidhje me përafrimin e rregulloreve teknike me legjislacionin e BE-së dhe ofrimin në kohë të informacionit për kompanitë e angazhuara në aktivitete eksporti, veçanërisht në vendet brenda BE-së.

## **1.5 Fusha specifike e ndërhyrjes: Thjeshtësimi i mjedisit ligjor dhe rregullator dhe miratimi i një përkufizimi të ri për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme**

### *1.5.1 Masa: Rritja e shfrytëzimit të Vlerësimit të Ndikimit Rregullator (VNR) përmes një kornize ligjore të përmirësuar për VNR-në dhe pilotimin për "Testin e NVM-ve"*

Vlerësimet e ndikimit rregullator nxisin një qeverisje më efektive, efikase dhe transparente, duke përfituar si institucionet ashtu edhe bizneset, duke siguruar që ligjet të jenë të hartuara mirë, të qëndrueshme dhe në përputhje me qëllimet më të gjera të politikave. Kjo praktikë promovon transparencën dhe llogaridhënien në zbatimin e politikave, duke ndihmuar në përmirësimin e ligjeve për të mbështetur më mirë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme . Përdorimi i zgjeruar i Vlerësimit të Ndikimit Rregullator (VNR) i referohet një qasje më të avancuar dhe gjithëpërfshirëse për vlerësimin e ndikimeve të mundshme të ligjeve të propozuara dhe siguron që efikasiteti dhe ndikimi i politikave të vlerësohen vazhdimisht. Kjo përfshin kryerjen e analizave gjithëpërfshirëse dhe sistematike, rritjen e angazhimit të palëve të interesuara, në përfshirjen e alternativave dhe opsioneve, si dhe monitorimin, vlerësimin, transparencën dhe llogaridhënien .

Kjo përfshin gjithashtu përdorimin e 'testit të SME-ve' që do të analizojë efektet e propozimeve të ardhshme legjislativë mbi SME-të, duke përdorur përvojën nga BE-ja. <sup>69</sup>Testi i NVM-ve vlerëson kostot dhe përfitimet e opsioneve të politikave për NVM-të, promovon parimin 'Mendo të Vogla të Para' dhe kontribuon në përmirësimin e mjedisit të biznesit. Ai identifikon efektet që NVM-të mund të përjetojnë nga kuadri i ri rregullator, organizon konsultime me NVM-të, vlerëson ndikimet mbi NVM-të (analiza e kostos dhe përfitimit) dhe eksploron opsionet e politikave që do të zvogëlonin efektet negative mbi NVM-të ose, nëse është e nevojshme, propozon masa zbutëse. Brenda planit të veprimit, parashikohet që Ministria e Administratës Publike, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Tregtisë, do të zhvillojë një metodologji të re të VNR-së (duke përshtatur pyetjet e testit të NVM-ve dhe duke i integruar ato në seksionin e ndikimit ekonomik të Raportit VNR), dhe do të ofrojë asistencë teknike dhe trajnim për të forcuar kapacitetet e brendshme të institucioneve.

### *1.5.2 Masa: Thjeshtësimi i procedurave administrative për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme*

Bizneset kanë nevojë për procedura të thjeshtëuara kur merren me institucionet publike. Kjo u kursen kohë dhe burime financiare. Edhe pse, në vitet e kaluara, disa iniciativa kanë kontribuar në reduktimin dhe thjeshtimin e procedurave administrative, ka ende hapësirë për optimizim të mëtutejshëm, pra reduktimin e procedurave administrative. Thjeshtësimi i barrës administrative kontribuon gjithashtu në reduktimin e ekonomisë informale, së bashku me reduktimin e kostove

<sup>68</sup><https://trainsonline.unctad.org/home>

<sup>69</sup> [https://single-market-economy.ec.europa.eu/smes/sme-strategy-and-sme-friendly-business-conditions/sme-test\\_en](https://single-market-economy.ec.europa.eu/smes/sme-strategy-and-sme-friendly-business-conditions/sme-test_en)

administrative për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Thjeshtësimi i procedurave administrative kërkon gjithashtu dixhitalizimin e proceseve, bashkëpunimin ndërinstitucional dhe zbatimin e plotë të parimeve të shërbimit me një ndalesë (parimi vetëm një herë) <sup>70</sup>.

### *1.5.3 Masa: Thjeshtësimi i procedurës për heqjen e kompanive nga Regjistri Qendror*

Rishikimi i procedurave për heqjen e kompanive nga regjistri mund të zvogëlojë pengesat e panevojshme birokratike, duke e bërë më të lehtë për sipërmarrësit të lundrojnë në mjedisin e biznesit. Thjeshtësimi i këtij procesi mund të ndihmojë në përmirësimin e përputhshmërisë së biznesit dhe në uljen e barrierave të daljes për sipërmarrjet e dështuara, duke siguruar një peizazh dinamik sipërmarrës. Për ta zbatuar këtë në praktikë, kërkohet koordinim më i mirë institucional, ndryshimi i rregulloreve përkatëse dhe zbatimi i programeve të ndërtimit të kapaciteteve për stafin që punon në institucionet përkatëse, por edhe për palët e tjera të interesuara, siç janë sipërmarrësit, kontabilistët, etj. Gjithashtu kërkon miratimin e Ligjit të Falimentimit dhe reformën e sistemit të falimentimit që do të lejojë rimëkëmbjen e firmave në vështirësi ose daljen më të shpejtë të firmave të falimentuara bazuar në praktikatat më të mira ndërkombëtare .

### *1.5.4 Masa: Harmonizimi i rregullores në lidhje me definicionin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në përputhje me definicionin e BE-së*

Deri më tani, Republika e Maqedonisë së Veriut ka përdorur një definicion të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme që nuk korrespondon me atë të miratuar nga Bashkimi Evropian. Në kuadër të planit të veprimit, parashikohet të ndryshohet rregullorja dhe të miratohet një definicion i ri i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, i cili do të zbatohet në nivel kombëtar me të gjitha aktet ligjore.

## **1.6 Fusha specifike e ndërhyrjes: Promovimi dhe mbështetja e sipërmarrjes**

### *1.6.1 Masa: Aktivitete për ngritjen e ndërgjegjes për të promovuar sipërmarrjen dhe sipërmarrësit e suksesshëm*

Aktivitetet për ngritjen e ndërgjegjes, të tilla si konferenca, ngjarje që promovojnë kompani të reja fillestare dhe ndërmarrje të vogla dhe të mesme të suksesshme (p.sh. Java Globale e Ndërmarrësisë, Çmimet për Start-up-in e Muajit dhe Start-up-in e Vitit, Sipërmarrësja e Vitit, Java Evropiane e NVM-ve, Sipërmarrësja Gruaja e Vitit, etj.), konkurset kombëtare të planeve të biznesit, promovimi i ndërmarrjeve shkollore dhe iniciativa të ngjashme, synojnë të forcojnë frymën sipërmarrëse në shoqëri, veçanërisht tek të rinjtë. Kjo çon në zhvillimin e një mendësie sipërmarrëse, inkurajimin e të menduarit kreativ, forcimin e bashkëpunimit me sektorin akademik dhe komunitetin e hukumtues, si dhe fillimin e themelimit të kompanive të reja fillestare dhe zgjerimin e bizneseve ekzistuese. Përveç kësaj, në kuadër të kësaj mase, do të promovohet edhe Projekti i Vetëpunësimit, veçanërisht në zonat rurale, tek grupet e qytetarëve në nevojë, tek grat sipërmarrëse potenciale, etj.

---

<sup>70</sup>[https://commission.europa.eu/news/once-only-principle-system-breakthrough-eus-digital-single-market-2020-11-05\\_en](https://commission.europa.eu/news/once-only-principle-system-breakthrough-eus-digital-single-market-2020-11-05_en)

### *1.6.2 Masa: Paralajmërim i Hershëm*

Brenda kuadrit të kësaj mase, është planifikuar të përcaktohet një metodologji dhe të krijohet një sistem paralajmërimi i hershëm për identifikimin e vështirësive të mundshme në operacionet e ndërmarrjeve, ndërmarrjen e masave dhe zbatimin e procedurave për të kapërcyer falimentimin e ardhshëm të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme debitoare, si dhe informimin në kohë të kreditorëve. Sistemi i paralajmërimit të hershëm do të bazohet në praktikën e mira nga sisteme të ngjashme tashmë të vendosura në BE.

### *1.6.3 Masa: Promovimi i Shansit të Dytë*

Parimi i një shansi të dytë synon të inkurajojë ata sipërmarrës që nuk patën sukses në përpjekjen e tyre të parë për ta bërë biznesin e tyre të suksesshëm. Qëllimi është të krijohet një sistem "shansi i dytë" duke forcuar iniciativat që mbështesin rifillimin e aktiviteteve të biznesit. Rritja e rrjetëzimit midis sipërmarrësve që kanë dështuar, por që janë përpjekur përsëri, është çelësi për të inkurajuar sipërmarrësit që të bëjnë një përpjekje të dytë dhe të marrin një mundësi tjetër për të filluar biznesin e tyre. Ky sistem, ndër të tjera, duhet të ofrojë gjithashtu mbështetje mentorim nga sipërmarrës me përvojë për ata që po rihapin bizneset e tyre.

## **1.7 Fusha specifike e ndërhyrjes: Ndërveprimi me Qeverinë**

### *1.7.1 Masa: Përmirësimi i pjesëmarrjes së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në procedurat e prokurimit publik*

#### *procedurat e prokurimit publik*

Pjesëmarrja e sektorit të NVM-ve, veçanërisht pjesëmarrja e ndërmarrjeve të vogla, nuk është në nivel të kënaqshëm kur bëhet fjalë për pjesëmarrjen në procedurat e prokurimit publik. Një nga arsytet për këtë është mungesa e njohurive dhe njohurive të ndërmarrja për prokurimin publik. Shumë sipërmarrës ende e konsiderojnë pjesëmarrjen në procedurat e prokurimit të kushtueshme dhe komplekse. Për më tepër, shumë nga pjesëmarrësit potencialë nuk inkurajohen të marrin pjesë në këto procedura sepse konsiderojnë se tenderët tashmë u janë "dhënë" operatorëve të tjerë të biznesit. Të gjithë këta faktorë kontribuojnë në një pjesëmarrje më të ulët, veçanërisht të ndërmarrjeve mikro dhe të vogla në procedurat e prokurimit publik. Për të rritur pjesëmarrjen e tyre, duhet të zbatohen disa masa që do të kontribuojnë në një pjesëmarrje më të lartë të këtyre ndërmarrjeve në prokurimin publik. Kjo përfshin uljen e tarifave të regjistrimit për NVM-të, prezantime falas dhe programe për ndërtimin e kapaciteteve për ndërmarrësit për t'i njohur ata me procedurat, si dhe përmirësimin e mekanizmave të kontrollit gjatë hartimit të procedurave të thjeshta të tenderimit, etj.

Gjithashtu, gjatë periudhës së ardhshme, përdorimi i sistemit të tregut elektronik për procedurat e prokurimit me vlerë të ulët duhet të rritet, duke shfrytëzuar avantazhet e tregut elektronik për të marrë vlerën më të mirë për paratë dhe për të siguruar përdorimin efikas të burimeve.

### *1.7.2 Masa: Zgjerim i mëtejshëm i ofertës së portalit kombëtar të shërbimeve*

Përmirësimi i mëtejshëm i portalit të shërbimeve elektronike "e-Qeverisje" përmes rritjes së numrit të shërbimeve të disponueshme në portal, si dhe përmirësimit e platformës ekzistuese të ndërveprimit, e cila do të jetë e destinuar për bashkëpunim ndërinstitucional <sup>71</sup>. Në këtë kontekst, institucionet në nivel kombëtar dhe lokal do të jenë në gjendje të krijojnë shërbime të reja elektronike për sipërmarrësit, të cilat do t'u kursejnë kohë në ndërveprimin e tyre me qeverinë. Në të njëjtën kohë, pritet edhe një ulje e kostove të bëra nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme për marrjen e dokumenteve të ndryshme administrative. Në këtë drejtim, është e nevojshme të futet parimi "Vetëm një herë" edhe në RMV, një koncept që synon të sigurojë që qytetarët dhe bizneset t'u japin autoriteteve dhe administratave informacione të caktuara standarde vetëm një herë. Duke përfshirë rregulloret e mbrojtjes së të dhënave dhe duke marrë pëlqimin e qartë të përdoruesve, administrata publike do të jetë në gjendje të ripërdorë dhe shkëmbejë të dhëna midis institucioneve të ndryshme.

### *1.7.3 Masa: Përmirësimi i Shërbimeve Elektronike(e-uslugi) për Licencat dhe Lejet*

Me këtë masë, pas hartëzimit të institucioneve që lëshojnë licenca dhe leje, procesi i aplikimit elektronik për licenca dhe leje duhet të thjeshtësohet, dhe koordinimi midis institucioneve përgjegjëse për lëshimin e licencave duhet të forcohet përmes krijimit të një sistemi një sportel për licencat, i cili do të përfshijë nënshkrimin dhe dorëzimin elektronik të dokumenteve, si dhe lëshimin elektronik të licencës.

## **1.8 Fusha specifike e ndërhyrjes: Përmirësimi i Shërbimeve të Zhvillimit të Biznesit (BDS) për NVM-të**

### *1.8.1 Masa: Zhvillimi i një sistemi akreditimin e konsulentëve*

Zhvillimi i mëtejshëm i tregut të konsulencës nëpërmjet ofrimit të programeve të çertifikuara nga konsulentë të çertifikuar duhet të përmirësohet më tej, si dhe sjellja e një sistemi njohjeje të përvojës së mëparshme të konsulentëve në ofrimin e programeve të ndërtimit të kapaciteteve. Kjo përfshin përmirësimin e bazës së të dhënave të konsulentëve ekzistues në INOVA duke përdorur praktikatat më të mira ndërkombëtare, por edhe sjelljen e një qasjeje tjetër sistematike në njohjen dhe validimin të ekspertizës së konsulentëve në nivel kombëtar. Kjo duhet të organizohet në bashkëpunim me rrjetin ekzistues të shoqatave të konsulencës dhe dhomave të tregtisë. Përveç kësaj, praktikatat tashmë të suksesshme si programet e mentorimit dhe konsulencës dhe skemat e kuponave për mbështetjen e ekspertëve duhet të mbështeten dhe forcohen edhe më tej në mënyrë që të mbështetet rritja e kompanive në të gjitha fazat e zhvillimit të tyre. Është e nevojshme të forcohet bashkëpunimi dhe koordinimi me Qendrën për Arsimin e të Rriturve, e cila akrediton programet e trajnimit.

---

<sup>71</sup> Sipas Planit të Veprimit të Axhendës së Reformave të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut (Shtojca 1, f. 25), furnizimi me shërbime elektronike pritet të rritet me 50% krahasuar me situatën aktuale deri në qershor 2027. Këto aktivitete po zbatohen brenda fushëveprimit të punës së Ministrisë së Transformimit Dixhital dhe në bashkëpunim me të gjithë palët e interesuara përkatëse.

Kjo masë do të rezultojë në zhvillimin e një sistemi për akreditimin e konsulentëve në përputhje me praktikën më të mira evropiane, si dhe në krijimin e lidhjeve me Fondacionin Evropian për Menaxhimin e Cilësisë.

#### *1.8.2 Forcimi i kapaciteteve të trajnerëve/konsulentëve që ofrojnë programe për ndërtimin e kapaciteteve për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme*

Programet "Trajnimi i trajnerëve" kanë një rëndësi të madhe kur bëhet fjalë për rritjen e kapaciteteve brenda ndërmarrjeve, pasi ato sigurojnë që ata që janë përgjegjës për arsimin dhe ndërtimin e kapaciteteve të jenë të pajisur me aftësitë e duhura, njohuritë e përditësuara dhe metodologjitë për ofrimin efektiv të trajnimit. Kur zbatohen programet "trajnimi i trajnerëve", ato duhet të jenë në përputhje jo vetëm me nevojat e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, por edhe me trendet globale dhe kërkesat e certifikimit në mënyrë që të jenë efektive kur zbatohen në praktikë. Programet e trajnimit duhet të zbatohen në partneritet me shoqatat e konsulentëve, organizatat e mbështetjes së biznesit dhe rrjetet e agjencive që mbështesin ndërmarrjet (ndër të tjera, qendrat rajonale që veprojnë nën ombrellën e INOVA-s). Trajnimet mund të mbulojnë tema të avancuara siç janë shfrytëzimi i inteligjencës artificiale në operacionet e përditshme, optimizimi i proceseve përmes metodologjisë Lean Six Sigma, si dhe trajnime bazë në burimet njerëzore, logjistikë, shitje, marketing dixhital, Excel të avancuar ose menaxhim financiar. Një qasje sistematike, ku shërbimet e zhvillimit të biznesit ofrojnë mbështetje për rritjen e kompanisë në të gjitha fazat e zhvillimit të tyre, është një nga aktivitetet kryesore në këtë fushë.

#### *1.8.3 Masa: Ndërkombëtarizimi i NVM-ve*

Të krijohet një kuadër strategjik për të ofruar mbështetje për NVM-të në zbatimin e aktiviteteve të ndërkombëtarizimit që çojnë në qasjen e tregjeve rajonale dhe globale duke ofruar udhëzime, burime dhe mbështetje për zgjerim ndërkombëtar. Ky kuadër duhet të ndërtohet mbi praktikën më të mira të zbatuara tashmë në vend dhe të mbështetura nga organizatat dhe projektet ndërkombëtare. Planifikimi dhe zbatimi i këtyre aktiviteteve duhet të përfshijë mbështetje të shtuar për pjesëmarrjen në panairë, ekspozita dhe konferenca ndërkombëtare. Përfshirja e dhomave të tregtisë dhe shoqatave të tjera sektoriale është thelbësore për përcaktimin e aktiviteteve specifike që do të përshpejtojnë procesin e "hyrjes në tregje të reja" dhe do të shtojnë vlerat përmes transferimit të njohurive në planifikimin e masave dhe programeve konkrete. Një pjesë e veçantë e kësaj mase do të përqendrohet gjithashtu në punën me kompanitë për përgatitjen e tyre "të brendshme" për hyrjen në tregjet ndërkombëtare (gatishmëria për eksport), trajnimin mbi zbatimin e standardeve, si dhe lidhjen e tyre me klastera, platforma ndërkombëtare, etj.

#### *1.8.4 Masa: Rritja e pjesëmarrjes së NVM-ve në Zinxhirët kryesorë me vlerë ndërkombëtare*

Identifikimi dhe zhvillimi i programeve mbështetëse për rritjen e pjesëmarrjes në zinxhirët kryesorë ndërkombëtarë të vlerave të NVM-ve që kanë kapacitet për të pasur sukses është jetike për t'i mundësuar këtyre bizneseve të zgjerohen në tregjet ndërkombëtare. Megjithatë, për ta arritur këtë, sipërmarrësit duhet të kenë njohuri paraprake rreth kërkesave të hyrjes, por edhe kapacitete

për t'iu përgjigjur kërkesave të zinxhirëve ndërkombëtarë të vlerave. Në këtë drejtim, me mbështetjen e duhur teknike dhe të ekspertëve, është e nevojshme të përgatiten ndërmarrjet që kanë potencialin të jenë pjesë e këtyre zinxhirëve ndërkombëtarë të vlerave. Kjo përfshin transferimin e njohurive teknike, përgatitjet për kërkesat e certifikimit, forcimin e kapaciteteve të brendshme të ndërmarrjeve etj., rritjen e ndërgjegjësimit rreth trendeve të operacioneve, etj. Përveç kësaj, duhet të inkurajohet pjesëmarrja në zinxhirët rajonalë të vlerave, si dhe nxitja e bashkëpunimit me investitorët e huaj të drejtpërdrejtë në vend.

#### *1.8.5 Masa: Ofrimi i trajnimeve për NVM-të dhe sipërmarrësit potencialë*

Trajnimi mbi format e reja të marketingut ose kanaleve e shitjes, aftësitë sipërmarrëse, financat, përdorimi i inteligjencës artificiale dhe fusha të tjera do të rrisin kapacitetet e brendshme të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe konkurrueshmërinë e tyre, duke i ndihmuar ato të eksplorojnë tregjet potenciale ku mund të ofrojnë produktet dhe shërbimet e tyre. Këto programe për ndërtimin e kapaciteteve do të forcojnë aftësitë e sipërmarrësve dhe punonjësve të tyre dhe do të përmirësojnë njohuritë mbi mënyrat e reja për të promovuar dhe shitur produktet, si dhe mënyrën e aksesit në financim përmes mjeteve jo tradicionale. E gjithë kjo duhet të nxisë të menduarit kreativ dhe do të kontribuojë në ndryshimin e mendësisë së sipërmarrësve në përputhje me trendet e reja globale të biznesit. Një segment i veçantë i trajnimit do të përqendrohet te sipërmarrësit potencialë, duke paraqitur mundësi për të përdorur franchising si një model për fillimin e biznesit, përdorimin e inteligjencës artificiale si një mjet për fillimin dhe zhvillimin e bizneseve ekzistuese etj.

#### *1.8.6 Mbështetje për NVM-të gjatë Zbatimit të Sistemeve dhe Standardeve Ndërkombëtare për kualitet*

Një pengesë e zakonshme për të hyrë në tregjet ndërkombëtare ose për të siguruar punë si nënkontraktorë për kompanitë ndërkombëtare (p.sh., investime të huaja të vendosura në zonat e zhvillimit teknologjik-industrial) është mungesa e certifikimeve të duhura midis NVM-ve. Kjo masë synon pikërisht rritjen e numrit të standardeve të mbajtura nga NVM-të tona, duke ofruar mbështetje për proceset e standardizimit (standardet ISO - Organizata Ndërkombëtare për Standardizim, standardet ushqimore HALAL, etj.) përmes bashkëfinancimit të duhur të proceseve të trajnimit dhe certifikimit. Përveç kësaj, kjo masë do të mbështesë kompanitë në lidhje me regjistrimin e të drejtave të pronësisë intelektuale (patentat, markat tregtare, etj.) si në nivel vendas ashtu edhe në atë ndërkombëtar.

### **1.9 Fusha specifike e ndërhyrjes: Nxitja dhe zhvillimi i njohurive sipërmarrëse**

#### *1.9.1 Masa: Zgjerimi i programeve dhe trajnimeve të edukimit për sipërmarrjen .*

Zgjerimi i programeve të edukimit sipërmarrës në shkolla, gjimnaze dhe sisteme arsimore profesionale nxit një kulturë inovacioni dhe të menduarit sipërmarrës që në moshë të re . Prandaj, brenda kësaj mase, do të organizohen ngjarje dhe fushata promovuese, do t'u ofrohet mbështetje të rinjve në realizimin e ideve të tyre të biznesit, do të promovohet sipërmarrja sociale dhe do të

forcohen kapacitetet e studentëve për inovacione të gjelbra përmes menaxhimit të biznesit. Përveç aktiviteteve që synojnë të rinjtë, kjo masë do të përqendrohet edhe në ndërtimin e kapaciteteve të grupeve të tjera të synuara brenda ekosistemit sipërmarrës (mësues/profesorë, këshilla studentësh, borde drejtuese shkollash, etj.).

### *1.9.2 Masa: Zhvillimi i mëtejshëm i programeve në Qendrën për Arsimin për të Rritur*

Forcimi i mbështetjes për zhvillimin e programeve në Qendrën e Arsimit për të Rritur për individët që duan të fillojnë biznesin e tyre në industri të ndryshme. Këto programe u ofrojnë sipërmarrësve të ardhshëm aftësi dhe njohuri praktike për të filluar dhe menaxhuar me sukses bizneset e tyre. Programe të tilla janë gjithashtu të rëndësishme për përmirësimin e aftësive dhe rikualifikimin e fuqisë punëtore, jo vetëm për shkak të konkurrueshmërisë, por edhe për shkak të tranzicionit të gjelbër dhe dixhital, i cili në mënyrë të pashmangshme do të çojë në mbylljen e vendeve të caktuara të punës. Në këtë drejtim, është thelbësore të mbështeten qendrat rajonale të trajnimit, të cilat në të ardhmen mund të evoluojnë në Qendra të Ekselencës Profesionale <sup>72</sup>.

### *1.9.3 Masa: Mbështetja e Organizatave Joqeveritare (OJQ) dhe ofruesve të trajnimeve të përfshirë në edukimin për sipërmarrje*

Mbështetja e OJQ-ve që ofrojnë edukim sipërmarrës, pasi arsimi joformal zgjeron qasjen në mundësitë e të edukim sipërmarrës. Këto organizata luajnë një rol vendimtar në arritjen e popullatave të ndryshme (rajone të marginalizuara, rurale, etj.) dhe në ofrimin e trajnimeve të përshtatura që plotësojnë sistemet formale të arsimit. Përveç kësaj, ato mund të përfshihen në anketa/analiza të pavarura rreth ekosistemit sipërmarrës, aktivitete promovuese që lidhen me sipërmarrjen e të rinkëve, sipërmarrjen sociale, sipërmarrjen e grave, etj.

### *Masa 1.9.4: Promovimi dhe Shfrytëzimi i Mundësive të Transferimit të Teknologjisë*

Forcimi i transferimit të teknologjisë në universitete synon të komercializojë aktivitetet kërkimore dhe zhvillimore të stafit universitar në kompani të suksesshme start-up. Mbështetja për krijimin e kompanive start-up dhe spin-off u mundëson universiteteve të nxisin inovacionin dhe sipërmarrjen, duke kontribuar në rritjen ekonomike dhe zhvillimin e industrive të teknologjisë së lartë. Forcimi i këtij procesi siguron që njohuritë të transformohen në inovacione komerciale, të adresojë sfidat shoqërore dhe të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm. Qendrat /zyrat e transferimit të teknologjisë duhet të jenë në përputhje me prioritetet e Strategjisë së Specializimit të Mençur - S3 <sup>73</sup> dhe duhet të promovojnë zhvillimin e aftësive në fusha të tilla si komercializimi, menaxhimi i pronës intelektuale dhe sipërmarrja, duke ofruar mundësi për studentët dhe studiuesit për të krijuar kompani start-up dhe spin-off <sup>74</sup>.

<sup>72</sup> Qendrat rajonale të përsosmërisë profesionale të themeluara nga Qeveria, si dhe qendra të tjera të përsosmërisë profesionale të themeluara në kuadër të skemave të ndryshme të financimit të projekteve (si Erasmus+, etj.).

<sup>73</sup> S3 ( Strategjia e Specializimit të Mençur )

<sup>74</sup> Kjo masë është në përputhje me axhendën e reformave të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut (Masa 4.1.4 nga Plani i Veprimit, Shtojca 1, f. 42).

## **1.10 Fusha specifike e ndërhyrjes: Mbështetja e sipërmarrjes së grave**

### *1.10.1. Masa: Promovimi dhe Përmirësimi i Sipërmarrjes së Grave*

Promovimi dhe rritja e sipërmarrjes së grave do të kontribuojë në rritjen e rritjes ekonomike. Në të njëjtën kohë, është e nevojshme të zhvillohet një mjedis biznesi që njeh nevojat e tyre specifike, duke krijuar kushte që i lehtësojnë gratë të krijojnë dhe drejtojnë biznese. Janë planifikuar aktivitete promovuese, punëtori dhe konferenca që do të përmirësojnë më tej pjesëmarrjen e grave në sektorin e biznesit, si themeluese por edhe në pozicione kyçe menaxheriale.

### *1.10.2 Masa: Zhvillimi i Udhërrëfyesit për Sipërmarrjen e Grave*

Përgatitja e një kuadri politikave që do të përcaktojë qëllimet dhe prioritetet e sipërmarrjes së grave për të ardhmen dhe do të forcojë më tej sipërmarrjen e grave në vend. Ky udhërrëfyes do të përdoret si bazë për hartimin e masave dhe programeve të detajuara për mbështetjen dhe zhvillimin e këtij grupi të synuar. Përveç kësaj, brenda kësaj mase, është planifikuar rritëzimi rajonal i shoqatave të biznesit të grave dhe ndarjes së ndërsjellë të praktikave të mira.

## **1.11 Fusha specifike e ndërhyrjes: Mbështetje për sipërmarrjen sociale dhe trashëgiminë e biznesit familjar (gjenerata e dytë e pronarëve)**

### *1.11.1 Masa: Mbështetje për sipërmarrjen sociale*

Ofrimi i mbështetjes për sipërmarrjet sociale është e rëndësishme sepse adreson sfidat shoqërore, ndërkohë që nxit zhvillimin ekonomik, krijon vende pune dhe promovon përfshirjen sociale. Duke investuar në ndërmarrje sociale, qeveria mund të nxisë inovacionin në zgjidhjen e çështjeve kritike si varfëria, pabarazia dhe qëndrueshmëria r mjedisit, duke i sjellë dobi komuniteteve dhe ekonomisë në përgjithësi. Bazuar në këtë, të mbështetet më tej zhvillimi i kuadrit politik dhe ligjor për një njohje më të mirë dhe të përcaktohen masat që do të mbështesin instrumentet dhe aktivitetet e këtij lloji.

### *1.11.2 Masa: Mbështetje për gjeneratën e dytë (të ardhshme) të pronarëve të bizneseve familjare*

Mbështetja e gjeneratës së dytë të pronarëve të bizneseve familjare është thelbësore për vazhdimësinë, rritjen dhe suksesin e ndërmarrjeve familjare. Gjeneratës së dytë mund t'i mungojë përvoja ose aftësitë për të menaxhuar kompleksitetin e mjediseve moderne të biznesit. Nevojiten programe të caktuara për trajnim, mentorimi dhe edukim për t'i pajisur ata me aftësitë e lidershit, inovacionit, financave dhe menaxhimit për ta drejtuar biznesin në mënyrë efektive në të ardhmen, duke marrë në konsideratë trendet aktuale të tregut në të cilat operojnë këto biznese .

## **1.12 Fusha specifike e ndërhyrjes : Mbështetje për përdorimin e IA-së (inteligjencës artificiale) në punën e NVM-ve**

### *1.12.1 Masa: Mbështetje për inkorporimin e inteligjencës artificiale për NVM-të*

Teknologjitë moderne dixhitale dhe zhvillimi i inteligjencës artificiale (IA) përfaqësojnë realitetin e ri në të cilin operojnë kompanitë. Nëse ndërmarrjet e vogla dhe të mesme vendase duan të

konkurrojnë në tregjet ndërkombëtare dhe të rrisin konkurrueshmërinë e tyre si në nivel lokal ashtu edhe në atë global, zbatimi i inteligjencës artificiale në puën e tyre të përditshme është i pashmangshëm. Në kuadër tplanit të veprimit, është planifikuar pilotimi i mjeteve të reja të lidhura me IA-në në rreth 20 kompani.

### **Objektivi I përhjithshëm Strategjik 2:**

***Sigurimi për NVM-të të kenë qasje të drejtë dhe më të thjesht deri tek zgjidhje të qëndrueshme dhe inovative për financim, duke i mundur ato të investojnë në rritje, inovacion dhe konkurrueshmëri, ndërkohë që nxisin qëndrueshmërinë në tregjet dinamike .***

Ky prioritet ka për qëllim të zgjerojë mundësitë e financimit për NVM-të duke rritur qasjen e instrumenteve alternative të financimit. Arritja e këtij objektivi strategjik nënkupton, ndër të tjera, thjeshtësimin e procedurave të aplikimit dhe uljen e barrierave administrative në mënyrë që instrumentet financiare të jenë më të arritshme për NVM-të .

Është e nevojshme të vazhdojnë aktivitetet që synojnë përafrimin e rregulloreve me kornizën (rekomandimet dhe prioritetet) e BE-së dhe institucioneve të tjera financiare ndërkombëtare, me qëllim zgjerimin e gamës së produkteve financiare në dispozicion të NVM-ve, futjen e skemave të garancisë së kreditit për lloje të caktuara të ndërmarrjeve, lehtësimin e transfertave bankare dhe mundësinë e pagesave me kartela kreditore për të gjitha llojet e transaksioneve, duke përfshirë pagesat ndërkombëtare. Për më tepër, përpjekjet e ardhshme duhet të përqendrohen në mundësimin e aksesit në platforma të tjera financiare që veprojnë globalisht, por aktualisht nuk janë të disponueshme në vendin tonë, gjë që në një farë mënyre kufizon konkurrueshmërinë e NVM-ve maqedonase. Bankat duhet të jenë të detyruara të kreditojnë shumat brenda 24 orëve <sup>75</sup>. Pritet që në të ardhmen e afërt, Maqedonia e Veriut të bëhet anëtare e Zonës së Përbashkët të Pagesave në Euro dhe të zbatojë rregulloret e saj.

Promovimi i njohurive financiare, veçanërisht tek të rinjtë, do të jetë një nga masat kryesore në kuadër të këtij prioriteti. Gjithashtu, është e nevojshme të rriten njohuritë në lidhje me mekanizmat alternative të financimit tek pronarët e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, në mënyrë që ata të mund të optimizojnë vendimet e tyre financiare.

Lehtësimi i financimit të gjelbër i referohet inkurajimit të kompanive për të rritur investimet e tyre në praktikat e qëndrueshme duke ofruar stimulime dhe fonde të dedikuara për projekte ekologjike nga qeveria dhe bankat.

Për më tepër, brenda këtij prioriteti, rekomandohet të përdoren platformat dixhitale për të lidhur ndërmarrjet e vogla dhe të mesme me mundësitë e financimit dhe për të përmirësuar transparencën në shërbimet financiare.

Përveç objektivit të përgjithshëm, ky prioritet përfshin edhe tre qëllime specifike, të cilat më pas degëzohen në masa dhe aktivitete:

**Objektivi specifik 1:** Përmirësimi i njohurive financiare tek NVM-të dhe të rinjtë

---

<sup>75</sup> Aktualisht, bankat nuk lejojnë pagesa të tilla - gjithashtu teknikisht të mundshme - pa dokumentacion në letër dhe/ose ndërkombëtarisht në raste të caktuara, duke mos lejuar p.sh. pagesat dixhitale për abonimet ndërkufitare; ose po ndalojnë transfertat bankare në raste të caktuara .

**Objektivi specifik 2:** Mundësim i aksesit më të madh në burimet financiare (si tradicionale ashtu edhe alternative) për NVM-të (duke përfshirë qasjen në fondet rajonale dhe evropiane)

**Objektivi specifik 3:** Rritja e dixhitalizimit të instrumenteve financiare dhe përputhja me praktikat dhe rregulloret më të mira të Bashkimit Evropian dhe tregjeve të tjera financiare.

## 2.1 Fusha specifike e ndërhyrjes: Përgatitja e NVM-ve për investime

### 2.1.1 Masa: Shfrytëzimi më i madh i përdorimit të instrumenteve alternative financiare <sup>76</sup>

Zbatimi i një ankete mbi metodat alternative të financimit midis NVM-ve është thelbësor për të kuptuar nevojat dhe sfidat e tyre financiare, duke mundësuar zhvillimin e iniciativave që kanë për synim mbështetjen. Hulumtime të tilla ndihmojnë në identifikimin e boshllëqeve në aksesin në financimin tradicional dhe nxjerrin në pah zgjidhje inovative që mund të forcojnë rritjen dhe qëndrueshmërinë e NVM-ve. Ato gjithashtu ofrojnë njohuri të vlefshme mbi trendet e reja të financimit, të tilla si financimi kolektiv ose huadhënia nga kolegët në kolegë, të cilat mund të përputhen më mirë me dinamikën e NVM-ve. Disa studime ndërkombëtare (e OECD SME's; and Entrepreneurship Financing Database; World Bank Enterprise Surveys; European Commission's SAFE; KPMG Alternative Lending Survey; PwC SME Pulse Reports etj.) mund të përdoren si pika referimi, pasi ato lejojnë krahasimin e trendeve rajonale dhe globale dhe lehtësojnë një kuptim më të thellë të zgjidhjeve efektive të financimit për NVM-të.

Në kuadër të planit të veprimit, është parashikuar zhvillimi i të paktën dy instrumenteve të reja alternative të financimit për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

### 2.1.2 Masa: Programi i gatishmërisë për investime për NVM-të

Përgatitja e NVM-ve për investime është thelbësore për rritjen dhe qëndrueshmërinë e tyre. Programi I Gatishmërie për Investime i pajis bizneset me aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për të tërhequr investitorët. Kjo përfshin rritjen e njohurive financiare, zhvillimin e planeve të forta të biznesit dhe kuptimin e pritjeve të investitorëve. Duke marrë pjesë në programe të tilla, NVM-të mund të paraqiten si mundësi të qëndrueshme investimi për investitorët, duke rritur kështu atraktivitetin e tyre për financuesit potencialë. Kjo masë do të ndërtohet mbi praktikën e mira ekzistuese vendase dhe/ose rajonale, të financuara kryesisht nga programet e donatorëve .

### 2.1.3 Masa: Forcimi i programeve për njohuritë financiare

Njohuritë financiare janë gur themeli për përmirësimin e aksesit në financa midis NVM-ve. Duke rritur kuptimin e tyre të koncepteve financiare, NVM-të mund të marrin vendime të informuara, të menaxhojnë financat e tyre në mënyrë efektive dhe të angazhohen me besim me institucionet financiare. Forcimi i programeve të njohurive financiare siguron që NVM-të të jenë më të pajisura dhe më të gjindshem në fushat financiare dhe për të përfituar nga mundësitë e disponueshme . Ky

---

<sup>76</sup> Kjo masë është në përputhje me Axhendën e Reformave të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut (seksioni 4.1.3. Promovimi i zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes miratimit dhe zbatimit të strategjisë së re për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, f. 42). ([https://www.mep.gov.mk/data/MK%20RA%20-%20Annex%201\\_EN.pdf](https://www.mep.gov.mk/data/MK%20RA%20-%20Annex%201_EN.pdf))

lloj programi duhet t'u mundësojë pronarëve të NVM-ve të kuptojnë si metodat tradicionale ashtu edhe ato alternative të financimit, në mënyrë që sipërmarrësit të mund të marrin vendimet më të përshtatshme për rritjen dhe zhvillimin e tyre në të ardhmen.

Programet e edukimit financiar të prezantuara për nxënësit e shkollave fillore kanë treguar rezultate pozitive gjatë zbatimit të tyre. Këto iniciativa duhet të përmirësohen dhe zgjerohen më tej për të siguruar qasje më të gjerë, duke u ofruar të gjithë nxënësve njohuri dhe aftësi thelbësore financiare që në moshë të re .

## **2.2 Fusha specifike e ndërhyrjeve: Promovimi i produkteve (alternative) financiare dhe mundësi për investime**

*2.2.1 Masa: Miratimi i një kuadri ligjor shtesë për biznes engjujt dhe promovimi i instrumenteve dhe mekanizmave financiare alternative, siç janë crowdfunding, investimet e biznes engjujve, kapitali sipërmarrës, sigurimi i kredive tregtare, etj.*

Mundësitë e financimit me kapitale, të tilla si financimi kolektiv, investimet nga biznes engjujt dhe kapitali sipërmarrës, luajnë një rol kyç në diversifikimin e burimeve të financimit për NVM-të. Promovimi i këtyre metodave të financimit u ofron NVM-ve akses më të madh në kapital, duke zvogëluar varësinë e tyre nga kreditë tradicionale bankare. Platformat e financimit kolektiv mund t'u mundësojnë NVM-ve të mbledhin fonde nga një bazë e gjerë kontribuesish, ndërsa biznes engjujt dhe kapitali sipërmarrës ofrojnë jo vetëm financim, por edhe mentorim dhe udhëzime strategjike, duke nxitur inovacionin dhe rritjen. Kjo masë synon të forcojë burimet vendase të financimit alternativ dhe t'i lidhë ato me burime/platforma ndërkombëtare. Ligji për biznes engjujt pritet të miratohet gjatë vitit 2025, gjë që duhet të stimulojë më tej burimet alternative të financimit.

*2.2.2 Masa: Analiza e instrumenteve specifike financiare (p.sh., faktoringu, lizingu, forfajtingu, etj.)*

RMV ka krijuar kornizën ligjore për funksionimin e instrumenteve financiare alternative. Megjithatë, hapat e ardhshëm në avancimin e përdorimit të tyre përfshijnë një analizë të detajuar të praktikave të mira ndërkombëtare në lidhje me llojet e ndryshme të instrumenteve specifike financiare (si faktoringu, lizingu, forfajtingu, etj.), si dhe rritjen e ndërgjegjësimit për këto instrumente dhe krijimin e infrastrukturës së nevojshme që do të lehtësojë aksesin e NVM-ve në forma të tilla të financimit. Në këtë kontekst, ekziston nevoja për të zgjeruar furnizimin e produkteve të faktoringut pa rekurs, për të futur faktoringun e kundërt dhe për të zhvilluar platforma të e-faktoringut për të mbështetur zinchirin e financimit të furnizimit. Iniciativat për të përmirësuar mjedisin e biznesit për faktoringun përfshijnë mbështetjen e integritetit të faturimit elektronik në nivel kombëtar, mirëmbajtjen e një regjistri kombëtar, krijimin e një platforme portali online, zhvillimin e një regjistri të shënimeve premtuese dhe krijimin e një regjistri të kolateralit, ndër të tjera.

*2.2.3 Masa: Lehtësimi i aksesit në kredi për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme nëpërmjet përdorimit të aseteve jo-materiale (pronësisë intelektuale - patentave, etj.) si kolateral në kreditimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme*

Për të zbatuar këtë masë, është e nevojshme të ndryshohet kuadri ligjor dhe disa akte nënligjore për të mundësuar përdorimin e aseteve të paprekshme si kolateral në kreditimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme nga institucionet financiare. Përveç kësaj, do të duhet të kryhen aktivitete promovuese përmes prezantimit të praktikave të mira ndërkombëtare dhe përvojave të tjera pozitive, me qëllim njohjen e kompanive vendase me mundësitë e reja për përdorimin e aseteve të paprekshme si kolateral në kreditimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

## **2.3 Fusha specifike e ndërhyrjes: Mobilizimi i financimit të BE-së, financimin Kombëtar dhe Privat për NVM-të**

*2.3.1 Masa: Përmirësimi i qasjes në programet e financimit të NVM-ve të BE-së, rajonale dhe kombëtare*

Lidhja e NVM-ve vendase me programe rajonale dhe të BE-së, siç janë Programi i Tregut të Vetëm, Horizonti i ri i Evropës (Single Market programme) I riu Horizont Europa (EIT, EIC), Erasmus+, Life+, Instrumenti për Ndihmë Para-Anëtarësimi, Interreg, Instrumenti i Lidhjes së Evropës (CEF) dhe të tjera, përmirësojnë aksesin e tyre në një gamë të gjerë mundësish financimi dhe rrjeteve mbështetëse. Këto programe ofrojnë burime financiare, asistencë teknike dhe mundësi rrjetëzimi që janë thelbësore për inovacionin dhe zgjerimin. Duke përmirësuar aksesin në këto programe, NVM-të mund të shfrytëzojnë mbështetjen kombëtare dhe të BE-së për të rritur konkurrueshmërinë e tyre dhe për t'u integruar në mënyrë më efektive në tregjet evropiane dhe globale. Posedimi i aftësive inteligjente është thelbësore për identifikimin e kompetencave të nevojshme për të rritur shkallën e suksesit të aplikimeve të NVM-ve për programet e financuara nga BE. Ky aktivitet do të plotësohet nga sesione gjithëpërfshirëse trajnimi mbi shkrimin e propozimeve të projektit, identifikimin e partnerëve për aplikime të përbashkëta dhe kuptimin e skemave të ndryshme të financimit nga BE dhe donatorë të tjerë.

## **2.4 Fusha specifike e ndërhyrjes: Rritja e gatishmërisë së NVM-ve për IPO (vetëm për fazën para-IPO)**

*2.4.1 Masa: Ndërtimi i kapacitetit të NVM-ve për Ofertën Publike Fillestare për të financuar nevojat e zhvillimit përmes tregut të kapitalit*

Rritja e përgatitjes së NVM-ve për ofertat publike fillestare (IPO) përfshin përgatitjen e tyre për fazat e ndryshme të daljes në publik. Kjo siguron që NVM-të të kenë vendosur standardet e nevojshme për raportimin financiar, strukturat e qeverisjes dhe planet strategjike. Gatishmëria para-IPO përqendrohet në përgatitjen e brendshme të kompanisë, faza IPO përfshin menaxhimin e procesit të ofertës publike, dhe faza pas-IPO siguron përputhshmëri dhe efektivitet të vazhdueshëm në tregun publik. Forcimi i përgatitjes për IPO mund t'u ofrojë NVM-ve kapital të konsiderueshëm për zgjerim dhe rritje të dukshmërisë së tregut. Meqenëse vendi ynë është në

fillimet e zhvillimit të IPO-ve, vetëm aktivitetet para-IPO do të zbatohen brenda afatit kohor të kësaj strategjie, kryesisht promovimi dhe edukimi i NVM-ve rreth të gjithë procesit të IPO-së.

## **2.5 Fusha specifike e ndërhyrjes: Krijimi i një mjedisi më të favorshëm dhe gjithëpërfshirës për qasjen në financa**

### *2.5.1 Masa: Krijimi i një Regjistri Online të Pasurive të Lëvizshme*

Regjistri online i asetëve të luhatshme mund të rrisë ndjeshëm aftësinë e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme për t'i përdorur këto asete si kolateral për hua bankare. Duke ofruar një platformë transparente dhe të arritshme, regjistri thjeshtëson procesin e dorëzimit të kolateralit, duke e bërë më të lehtë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të sigurojnë kredi dhe të përmirësojnë likuiditetin e tyre. Në fazën e parë, kërkohet një dizajn gjithëpërfshirës i bazës së të dhënave për të mbledhur një katalog të asetëve të luhatshme, të tilla si makineri, automjete, inventar dhe pronë intelektuale. Përveç kësaj, përfshirja e identifikuesve unikë (p.sh., numra serialë, përshkrime ose foto) për gjurmimin e saktë të asetëve do të jetë një përparësi gjatë zhvillimit të kësaj faze fillestare të masës .

### *2.5.2 Masa: Forcimi i skemës ekzistuese dhe krijimi i një skeme të re kreditore garantuese të kredisë për kompanitë e reja dhe ndërmarrjet e tjera të vogla dhe të mesme*

Krijimi i një Fondi të ri Garancie ose zgjerimi i fushëveprimit të mbulimit të Fondit aktual të Garancisë brenda Bankës së Zhvillimit synon të zvogëlojë kërkesat për kolateral dhe të rrisë aksesin në këto skema garancie për ndërmarrje të tjera me rezik më të lartë <sup>77</sup>. Brenda këtyre skemave të garancisë së kredisë, do të krijohen mekanizma për të zvogëluar rrezikun financiar për huadhënësit, duke u mundësuar kompanive të tjera të kenë akses më të lehtë në financim. Këto skema veprojnë si një rrjet sigurie duke garantuar një pjesë të shumës së kredisë, duke inkurajuar bankat dhe institucionet financiare të mbështesin bizneset e reja dhe inovative. Duke adresuar mungesën e kolateralit dhe rrezikun e lartë të perceptuar që lidhet me bizneset e reja, programe të tilla nxisin sipërmarrjen dhe stimulojnë rritjen ekonomike. Përveç kësaj, ato ndihmojnë në tejkalimin e hendekut të financimit për kompanitë e reja, veçanërisht ato të udhëhequra nga grupe të nën-përfaqësuar, duke promovuar përfshirjen dhe krijimin e vendeve të punës. Banka e Zhvillimit duhet të shërbejë si institucioni ku mund të zhvillohen skema të tilla.

### *2.5.3 Masa: Prokurimi i Pajisjeve për NVM-të në Përpunim dhe Sektorë të Tjerë Prioritarë të Përcaktuar në Strategjinë e Specializimit të Mençur*

Në përputhje me fushat prioritare të Strategjisë së Specializimit të Mençur, kjo masë parashikon krijimin e mekanizmave mbështetës (financim) për prokurimin e pajisjeve për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme, me fokusin kryesor të vendosur në industrinë prodhuese.

---

<sup>77</sup> Plotësimi me kredi nga kategoria e riskut B sipas regjistrimit të kredive të Bankës Kombëtare, me një përqindje maksimale garancie prej 35% të shumës kryesore. Është gjithashtu e mundur të regjistrohen kredi nga Banka e Zhvillimit që disbursohen përmes bankave pjesëmarrëse në portofolin e garantuar të Fondit të Garancisë.

## **2.6 Fusha specifike e ndërhyrjes : Përshtatja e Direktivës për Pagesat e Vonuara me rregulloren më të fundit të BE-së**

*2.6.1 Masa: Mbështetje për të futur në fuqi direktivën për vonesën në pagesa (pagesë deri në 30 ditë)*

Kjo masë do të jetë në përputhje me propozimin e ri të BE-së në lidhje me *Rregulloren për luftimin e pagesave të vonuara*<sup>78</sup> në transaksionet tregtare. Propozimi i BE-së prezanton një limit maksimal më të rreptë pagese prej 30 ditësh, eliminon paqartësitë dhe adreson boshllëqet ligjore në Direktivën aktuale . Me zbatimin e kësaj rregulloreje, likuiditeti i kompanive do të përmirësohet ndjeshëm përmes mbledhjes në kohë të kërkesave, gjë që do të kontribuojë në mënyrë indirekte në uljen e procedurave të falimentimit të filluara për shkak të mungesës së likuiditetit dhe pamundësisë për të shërbyer detyrimet ndaj furnizuesve.

Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet pagesave të bëra nga shteti. Nga ana tjetër, normat e interesit për mospërmbushje duhet të aplikohen automatikisht. Vëmendje duhet t'i kushtohet edhe vonesave në pagesat e pagave, si dhe vonesave në rimbursimet e TVSH-së nga Drejtoria e të Ardhurave Publike.

---

<sup>78</sup>[https://single-market-economy.ec.europa.eu/smes/challenges-and-resilience/late-payment\\_en](https://single-market-economy.ec.europa.eu/smes/challenges-and-resilience/late-payment_en)

### **Objektivi Strategjik 3:**

*Mbështetja e NVM-ve në adoptimin e praktikave të qëndrueshme dhe integrimin e teknologjive të përparuara dixhitale, duke i mundësuar ato të rrisin konkurrueshmërinë, të zvogëlojnë ndikimin mjedisor dhe të përputhen me trendet globale drejt një ekonomie më të gjellbër dhe më inovative .*

Ky objektivi përputhet me objektivat më të gjera të BE-së për arritjen e neutralitetit klimatik dhe një ekonomie të drejtuar nga dixhitalizimi deri në vitin 2050. Vendi ynë angazhohet të ndërmarrë reforma që synojnë përshtetimin e konvergencës socio-ekonomike të ekonomisë së saj me Bashkimin Evropian duke nxitur inovacionin, veçanërisht për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe në mbështetje të tranzicionit të gjellbër dhe dixhital, duke rritur cilësinë e sistemit të saj arsimor, trajnimin, rikualifikimin, përmirësimin e aftësive, politikat e punësimit, si dhe duke promovimin dhe transformimin dixhital si një mundësues për zhvillim të qëndrueshëm dhe rritje gjithëpërfshirëse .

Brenda këtij objektivi, pritet që masat e propozuara të inkurajojnë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të miratojnë modele dhe procese të qëndrueshme biznesi, të ulin emetimet e karbonit dhe të kalojnë në një ekonomi qarkulluese b përmes stimulimit dhe mbështetjes financiare.

Masat e lidhura me transformimin dixhital do të ofrojnë mjete, trajnime dhe burime për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme për integrimin e teknologjive të tilla si Inteligjenca Artificiale, Interneti i Gjërave dhe cloud computing për të përmirësuar produktivitetin dhe aksesin në treg.

Janë hartuar masa për t'i bërë iniciativat e gjelbra dhe dixhitale gjithëpërfshirëse duke adresuar barrierat me të cilat përballen ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) më të vogla, rurale ose me burime të kufizuara .

Objektivat specifikë sipas këtij prioriteti përfshijnë:

**Objektivi Specifik 1 :** Krijimi i një kuadri rregullator që do të mundësojë përdorimin më të madh të mjeteve dixhitale në komunikim me Qeverinë, duke rritur kështu efikasitetin në lëshimin e dokumenteve dhe paraqitjen e kërkesave drejtuar institucioneve.

**Objektivi specifik 2 :** Rritja e ndërgjegjësimit midis sipërmarrësve në lidhje me futjen e standardeve që do të kontribuojnë në një mjedis më të pastër dhe qëndrueshëm më të madhe të bizneseve të tyre përmes zbatimit të ekonomisë rrethore.

**Objektivi specifik 3 :** Zbatim më i gjerë i transformimit dixhital në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme duke ofruar mbështetje institucionale dhe burime financiare për zbatimin e masave konkrete.

### **3.1 Fusha specifike e ndërhyrjes: Korniza rregullatore për transformimin dixhital**

*3.1.1 Masa: Përmirësimi i kornizës rregullatore e cila do të mbështesë transformimin dixhital*

Krijimi i një mjedisi rregullator që inkurajon inovacionin dhe përshtatet me përparimet teknologjike është thelbësor për lehtësimin e kalimit pa probleme të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në proceset dixhitale. Kjo përfshin përmirësimin e ligjeve ekzistuese dhe inkorporimin e rregulloreve të reja që mbështesin sipërmarrjen dixhitale, tregtinë elektronike, privatësinë e të dhënave dhe sigurinë kibernetike. Duke krijuar një kuadër rregullator të favorshëm, Maqedonia e Veriut mund t'i inkurajojë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të përvetësojnë teknologjitë dixhitale, të përmirësojnë efikasitetin operativ dhe të forcojnë konkurrueshmërinë e tyre në tregun global.

Si pjesë e kësaj mase, parashikohet edhe zhvillimi i një portofoli dixhital për identitetin dixhital, së bashku me njohjen reciproke të nënshkrimeve elektronike dhe mjeteve elektronike të identifikimit midis vendeve të Ballkanit Perëndimor.

### **3.2 Fusha specifike e ndërhyrjes: Dixhitalizimi i sektorit bankar**

#### *3.2.1 Masa: Inkurajimi i NVM-ve për të Përdorur Mjete Dixhitale në punën e tyre, Veçanërisht në Fushën e Pagesave*

Metodat e pagesave dixhitale janë thelbësore në modernizimin e sektorit bankar. Ato u ofrojnë ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme alternativa më të shpejta, më të sigurt dhe më efektive nga ana e kostos ndaj sistemeve tradicionale të pagesave. Duke promovuar pagesat dixhitale, sektori bankar mund të rrisë përfshirjen financiare, të përmirësojë transaksionet dhe të zvogëlojë varësinë nga paratë e gatshme. Ky transformim është thelbësor që ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të konkurrojnë në mënyrë efektive në një ekonomi dixhitale .

### **3.3 Fusha specifike e ndërhyrjes: Krijimi i programeve që ndihmojnë rritjen nëpërmjet mbështetjes për dixhitalizimin e NVM-ve**

#### *3.3.1 Masa: Zhvillimi i programeve dhe instrumenteve për të rritur dixhitalizimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme*

Programet e që ndihmojnë rritjen janë të hartuar për të ndihmuar NVM-të të përshpejtojnë transformimin e tyre dixhital duke ofruar qasje në burime, mentorim dhe mjete teknologjike. Këto programe mund të rrisin aftësitë dixhitale të NVM-ve, duke i mundësuar ato të integrojnë teknologji të përparuara në veprimin e tyre . Duke marrë pjesë në programet e ngritjes, NVM-të mund të përmirësojnë produktivitetin, të nxisin inovacionin dhe të mbeten konkurruese në një peizazh dixhital që evoluon me shpejtësi. Në këtë drejtim, mbështetja për ofruesit lokalë duhet të rritet më tej në mënyrë që të jenë në gjendje të zhvillojnë dhe promovojnë dixhitalizim, automatizim dhe zgjidhje të përballeshme për të përmbushur nevojat specifike të NVM-ve dhe stimulim për institucionet financiare për të zhvilluar instrumente financiare të synuara (të tilla si kredi koncesionare me komponent granti) për dixhitalizimin dhe gjelbërimin e NVM-ve. Janë planifikuar programe të veçanta për të mbështetur mbrojtjen e NVM-ve në nivele të ndryshme (pajisje, të dhëna, rrjete, etj.) nga sulmet e hakerëve dhe vjedhja e të dhënave (Cyber security hygiene), gjegjësisht forcimin ndjeshëm të sigurisë kibernetike.

RMV duhet të prezantojë një program për të mbështetur dixhitalizimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, duke ndjekur shembullin e Austrisë (KMU.DIGITAL <sup>79</sup>), Hungarisë dhe vendeve të tjera nga rajoni i Ballkanit Perëndimor. Në këtë program, kompanitë vlerësohen duke përdorur një pyetësor të standardizuar dhe propozohen zgjidhje tashmë të provuara.

### **3.4 Fusha specifike e ndërhyrjes: Tranzicioni I NVM-ve në një ekonomi qarkulluese**

#### *3.4.1 Masa: Zhvillimi i programeve të specializuara të trajnimit që mbështesin kalimin në një ekonomi qarkulluese*

Kalimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) në një ekonomi qarkulluese është e rëndësishme për rritjen e qëndrueshmërisë dhe konkurrueshmërisë. Duke miratuar parimet e ekonomisë qarkulluese, NVM-të mund të minimizojnë mbeturinat, të optimizojnë përdorimin e burimeve dhe të krijojnë modele biznesi të qëndrueshme. Ky tranzicion jo vetëm që kontribuon në ruajtjen e mjedisit, por gjithashtu hap mundësi të reja tregu dhe nxitje të inovacionit. Pranimi i praktikave të ekonomisë qarkulluese mund të çojë në kursime të kostove, përmirësim të reputacionit të markës dhe rritje të qëndrueshmërisë ndaj mungesës së burimeve dhe presioneve rregullatore .

Është e nevojshme të sigurohen fonde për angazhimin e ekspertëve të ekonomisë qarkulluese për industri specifike dhe të organizohen punëtorë me ndërmarrjet e vogla dhe të mesme nga ato industri për të zhvilluar procese të brendshme qarkulluese (kjo përqendrohet kryesisht në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme prodhuese). Gjatë përcaktimit të prioritetëve (industrive) për financim në kuadër të kësaj mase, duhet të ndiqet Udhërrëfyesi i OECD-së drejt Ekonomisë qarkulluese ((A Roadmap towards Circular Economy of North Macedonia), e miratuar në mars 2024. Fokus i veçantë do t'i kushtohet zhvillimit të modeleve të biznesit të ekonomisë qarkulluese, si dhe prokurimit të laboratorëve të specializuar të ekonomisë qarkulluese për t'i shërbyer nevojave të NVM-ve.

#### *3.4.2 Masa: Mbështetje për NVM-të për inkorporimin e sistemeve dhe pajisjeve me efikasitet energjetike që përdorin burime të rinovueshme të energjisë*

Kjo masë parashikon dhënie të subvencioneve për instalimin e burimeve alternative të energjisë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (fotovoltaikë, turbina me erë, mini-hidrocentrale, pompa nxehtësie, etj.), si dhe trajnime mbi menaxhimin e energjisë në industri.

#### *3.4.3 Masa: Mbështetje për Kompanitë në Fushën e Riaftësimit dhe Përmirësimit të Aftësive të Punonjësve për Nevojat e Tranzicionit të Gjelbër*

Duke pasur parasysh që tranzicioni i gjelbër përfshin si mbylljen e vendeve të caktuara të punës ashtu edhe krijimin e roleve dhe kualifikimeve të reja të kërkuara për vendet e punës në industrinë në zhvillim të nxitura nga tranzicioni i dyfishtë, kjo masë parashikon mbështetje për zhvillimin e programeve të reja të trajnimit që lidhen me sektorin e energjisë së qëndrueshme

---

<sup>79</sup> <https://www.wko.at/foerderungen/kmu.digital>

(për shembull: instalues dhe teknikë mirëmbajtjeje të fotovoltaikeve, trajtues të baterive të automjeteve elektrike, etj.).

#### *3.4.4 Masa: Mbështetje për Sektorin Bankar në Prezantimin e Produkteve Financiare për të Promovuar Ekonominë Qarkulluese dhe Tranzicionin Dixhital dhe të Gjelbër*

Spektori bankar në Republikën e Maqedonisë së Veriut kohët e fundit ka filluar të ofrojë kredi "të gjelbra" për kompanitë. Qëllimi i kësaj mase është të forcojë kapacitetet e punonjësve në sektorin bankar për të prezantuar produkte financiare që mbështesin ekonominë qarkulluese, si dhe tranzicionin dixhital dhe të gjelbër, përmes huadhënies dhe mbështetjes financiare të përshtatshme për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

### **3.5 Fusha specifike e ndërhyrjes: Mbështetje për Zhvillimin e Kompanive të Gjelbra Start-up dhe Spin-off, dhe Zgjidhjeve dhe Teknologjive Inovative të Gjelbra brenda NVM-ve Ekzistuese**

#### *3.5.1 Masa: Zhvillimi i kompanive të gjelbra fillestare dhe spin-off kompanive dhe mbështetja për NVM-të në zhvillimin teknologjik të gjelbër*

Si pjesë e aktiviteteve të INOVA-s, janë planifikuar thirrje të dedikuara për të mbështetur kompanitë e sapokrijura (startup-e dhe spin-off-e) dhe NVM-të ekzistuese për një tranzicion të gjelbër më të lehtë:

- Grante bashkëfinancimi dhe mbështetje shtes teknike për Start up dhe spin off të gjelbra
- Grante bashkëfinancuese dhe asistencë shtes teknike për zhvillimin teknologjik të gjelbër të NVM-ve

### **3.6 Fusha specifike e ndërhyrjes: Mbështetje për kompanitë për të harmonizuar standardet mjedisore dhe standardet e tjera të qëndrueshmërisë**

#### *3.6.1 Masa: Mbështetja e programeve për harmonizimin e standardeve ndërkombëtare të gjelbra/dixhitale*

Standardet mjedisore dhe të qëndrueshmërisë për NVM-të janë udhëzime dhe korniza që synojnë të ndihmojnë bizneset të veprojnë në mënyrë të përgjegjshme, të zvogëlojnë gjurmën e tyre mjedisore dhe të përputhen me objektivat globale të qëndrueshmërisë. Këto standarde jo vetëm që i ndihmojnë NVM-të të kontribuojnë në ruajtjen e mjedisit, por edhe të rrisin konkurrueshmërinë e tyre duke tërhequr konsumatorë të ndërgjegjshëm për mjedisin, duke përmbushur kërkesat rregullatore dhe duke ju dhënë qasje në fonde ose stimulime të fokusuar në qëndrueshmëri. Mbështetja do të jetë në dispozicion për kompanitë për zhvillimin ose përmbushjen e :

- Standardit Mjedisor, standardet sociale dhe Qeverisje (Environmental Social Governance) - duke u përqendruar në këto standarde, ndërmarrjet mund të zbusin rreziqet e mundshme, të tërheqin investitorë, të ulin kostot dhe të ndërtojnë një reputacion pozitiv në shoqëri ;
- Mekanizmi i BE-së për Rregullimin e Kufirit të Karbonit - përafrimi me objektivat globale të klimës, përmbushja e pritjeve të tregut dhe ruajtja e konkurrueshmërisë në një peizazh rregullator në zhvillim e sipër të përqendruar në qëndrueshmëri ;

- Standardet e Gjurmëve të Karbonit (ISO 14064) dhe Protokoli i për gazrat e serrë- i ndihmojn NVM-të të matin, menaxhojnë dhe raportojnë emetimet e gazrave serrë për të zvogëluar ndikimin e tyre në karbon ;
- Standardi i Menaxhimit të Energjisë (ISO 50001) - udhëzon bizneset në përmirësimin e efikasitetit të energjisë dhe uljen e konsumit, etj.

## 6. Korniza për Monitorim, Vlerësim dhe Raportim

Monitorimi vlerësimi dhe raportimi në lidhje me Strategjinë e NVM-ve për Maqedoninë e Veriut është thelbësor për të siguruar që objektivat strategjike të zbatohen në mënyrë efektive dhe të japin ndikim të matshëm. Një sistem i strukturuar mirë për monitorim, vlerësim dhe raportim mundëson ndjekjen e vazhdueshme të progresit, identifikon sfidat e hershme të zbatimit dhe mbështet vendimmarrjen e bazuar në prova. Ai siguron llogaridhënie dhe transparencë midis të gjithë palëve të interesuara dhe ndihmon në ndarjen e buxhetit dhe burimeve në mënyrë më efektive. Duke vlerësuar sistematikisht rezultatet dhe treguesit të performancës të parashikuara në Planin e veprimit sistemi për MVR forcon kapacitetin institucional dhe rrit efektivitetin e politikave. Në fund të fundit, ai i lejon Maqedonisë së Veriut të përshtasë politikën e saj për NVM-të në përputhje me trendet ekonomike dhe nevojat në zhvillim, duke nxitur një sektor të NVM-ve elastik dhe konkurrues.

Sistemi i monitorimit vlerësimi dhe raportimit i Strategjisë së NVM-ve është në përputhje me *Metodologjinë për Përgatitjen, Zbatimin, Monitorimin, Raportimin dhe Vlerësimin e Strategjive Sektoriale*, të përcaktuar nga Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut. Ky harmonizim është thelbësor për të siguruar përputhshmëri me proceset kombëtare të planifikimit strategjik dhe për të përforcuar koordinimin institucional.

Axhenda e reformave të Qeverisë - veçanërisht angazhimi i saj strategjik për negociata të suksesshme për integrimin në BE - kërkon forcimin e sistemit të planifikimit strategjik duke krijuar një mekanizëm për harmonizimin e planifikimit afatgjatë, afatmesëm dhe vjetor si elementë të ndërlidhur të një kuadri të unifikuar planifikimi. Planifikimi strategjik në secilën fushë politike formon bazën për përcaktimin e shtigjeve të zhvillimit, mënyrave të veprimit dhe ndarjeve financiare, të cilat lidhin drejtpërdrejt strategjitë sektoriale me planifikimin afatmesëm dhe vjetor të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Kjo do të sigurohet nëpërmjet zbatimit të Planit të Veprimit, i cili përfshin një periudhë planifikimi trevjeçare për masat dhe aktivitetet, shumat financiare përkatëse me burimet e identifikuar të financimit në nivel të qëllimeve kryesore, rezultate me aktivitete të propozuara dhe ndikim i parapar dhe i realizuar tek çdonjera nga masat e parpara.

Ky objektivi përputhet me qëllimin më të gjerë të nxitjes së një ekosistemi dinamik dhe të qëndrueshëm të NVM-ve duke siguruar që burimet dhe përpjekjet të drejtohen drejt rezultateve me ndikim dhe të matshme. Parimet kryesore janë gurthemeli i aktiviteteve për monitorim vlerësim dhe raportim janë:

- **Vlerësim i Vazhdueshëm:** Monitoroni rregullisht efektivitetin e iniciativave dhe përshtatjen e politikave bazuar në njohuri me qëllim menaxhimin sfidave e reja.
- **Plani për angazhimin e të gjitha palëve të interesuara :** Përfshirja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, përfaqësuesve të industrisë, akademisë dhe palëve të tjera të interesuara në procesin e vlerësimi për të siguruar që strategjia të mbetet relevante dhe efektive.

- **Raportim Transparent** : Zhvillimi I treguesve të qartë dhe publikonmi i gjetjeve në koh për të demonstruar progresin dhe për të ndërtuar besim midis palëve të interesuara.
- **Mësimi dhe Përmirësimi** : Përdorni rezultateve nga vlerësimet për precizitet dhe përmirsim I masave ekzistuese, për të inkuorporuar iniciativa të reja dhe për të rritur praktikatat e suksesshme.

## 6.1. Mekanizmat për Zbatimin e Strategjisë

### 6.1.1. Autoritetet Kompetente Përgjegjëse për Zbatimin, Monitorimit, Vlersimit dhe Raportimit

Ngritja e një organi formal koordinues është thelbësore për zbatimin efektiv të politikave dhe masave për NVM-të. Ky grup pune luan një rol qendror në sigurimin që elementët të ndryshme të strategjisë për NVM-të të ekzekutohen në mënyrë efikase dhe kohezive.

Për organizimin efektiv të monitorimit dhe vlerësimit, është thelbësore të krijohet një sistem funksional me role dhe përgjegjësi të qarta të përcaktuara . Ky sistem do të përbëhet nga një grup operativ kryesor përgjegjës për koordinimin dhe zbatimin e procesit të monitorimit vlersimit dhe raportimit.

Grupi do të përfshijë staf nga Departamenti për Sipërmarrjen dhe Konkurrueshmërinë e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM) të Ministrisë së Ekonomisë dhe Punës , Zyra e Kryeministrit dhe Zyra e Sekretariatit të Përgjithshëm.

Përveç grupit operativ, aktivitetet e monitorimit dhe vlerësimit do të përfshijnë anëtarë të grupit të punës që asistuan në përgaditjen e Strategjis, vlerësues të jashtëm dhe palë të tjera të interesuara përkatëse. Një përmbledhje e detajuar e roleve, përgjegjëse dhe procesit të monitorimit dhe vlersimit si dhe kërkesave për krijimin e një sistemi të monitorimit dhe vlerësimi i bazuar në IT, dhe është i dorzuar në një dokument të veçantë i titulluar *Sistemi i vlersimit i IT Mjeteve* , i cili është bashkëngjitur Strategjisë dhe Planit të Veprimit.

Grupi operativ i punës për monitorim dhe vlersim të Strategjisë së NVM-ve do të kryejë një rishikim të treguesve të nivelit të rezultateve të paktën çdo gjashtë muaj. Treguesit e nivelit të rezultateve do të monitorohen në përputhje me afatet kohore të përcaktuara në Planin e Veprimit. Disa tregues do të gjurmohen vazhdimisht ose në bazë vjetore, varësisht nga disponueshmëria e të dhënave dhe ciklet e raportimit institucional. Megjithatë, një pjesë e treguesve të nivelit të rezultateve dhe ndikimit është e lidhur drejtpërdrejt me zbatimin e plotë të Planit të Veprimit dhe për këtë arsye do të monitorohet gjatë një periudhe tre-vjeçare. Ky cikël monitorimi tre-vjeçar do të përkojë me zbatimin e vlerësimit afatmesëm, i cili është në përputhje me kohëzgjatjen e Planit të parë tre-vjeçar të Veprimit.

Në fillim të vitit 2028, Strategjia do t'i nënshtrohet një vlerësimi dhe shqyrtimi afatmesëm nga grupi i punës, duke marrë në konsideratë progresin e bërë në zbatimin e saj në dy vitet e mëparshme. Ky proces do të përfshijë gjithashtu pjesëmarrjen e OJQ-ve, sektorit të biznesit, përfaqësuesve nga akademia, sindikatave të punëtorëve etj., përmes përfshirjes së tyre në grupin e punës.

Në figurën numër 13 është prezentuar ekosistemi sipërmarrës në shtetin ton dhe rolin e grupit të punës në procesim e momnitorimit, vlersimit dhe raportimit dhe lidhjen e saj me palët e interest, ndërsa në tabelën me numër 4 është prezentuar roli I secilit nga palët e interest dhe përgjegjësitë në procesin e monitorimit, vlersimit dhe raportimit



Fotografija 13. Pozitat e Grupit të punës pë MVR dhe raportimi për strategjinë për NVM-të 2025-2030 në kuadër të ekosistemit sipërmarrës

Tabela 4. Roli dhe përgjegjësit e faktorëve kyq ne procesin e monitorimit, raportimit dhe implementimit të Strategjis për NVM-të 2025 2030

Grupi i palëve të interesuara	Anëtarët	Rolet kyçe dhe Përgjegjësitë
-------------------------------	----------	------------------------------

<b>Grupi i Punës për përgatitjen e strategjis për NVM-të</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ministritë dhe agjencionet</li> <li>- Qeverisja lokale/regjionale</li> <li>- Odat ekonomike dhe organizatat për përkrahje të biznesit</li> <li>- Institucionet Akademike dhe OJQ-të</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Sigurimi i udhëzimeve për politikën</li> <li>- Rishikimi dhe analizimi i gjetjeve të realizuara SOI-ja e</li> <li>- Përshtatja e monitorimit me objektivat strategjike dhe propozimi i masave për përmirësimin e planit të veprimit</li> <li>- Pjesëmarrja në evaluime</li> </ul>
<b>Evaluator të jashtëm</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Konsulent të pavarur ose kompani konsultative</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Realizimi i evaluimeve të mesme dhe përfundimtare</li> <li>- Validimi i rezultateve nga rezultati dhe ndikimi</li> <li>- Dorzimi i rezultateve</li> </ul>
<b>Sigurimi i statistikave/ të dhënave</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Enti shtetëror për statistika</li> <li>- Bartësit e të dhënave për sektorin</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Dorzimi i statistikave zyrtare dhe mbledhje të të dhënave</li> <li>- Sigurimi i qasjes dhe kualitetit të regjestrave</li> </ul>
<b>Përfqësues të sektorit privat</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- NVM</li> <li>- Shoqata biznesi</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Shpërndarja e informacioneve për ndikimin e strategjisë</li> <li>- Pjesëmarrja në konsultime</li> </ul>
<b>Donatorë/Partnerë Ndërkombëtarë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- BE, BB, BERZH, etj.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Harmonizimi i mbështetjes së jashtme me sistemin nacional MVR</li> <li>- Ndarja e ekspertizës teknike dhe vendosja e pikave referuese</li> </ul>

### 6.1.2. Procedura dhe Dinamika e Raportimit dhe Vlerësimit të Rezultateve të Arritura – Korniza e Monitorimit dhe Vlerësimit dhe raportimit për Strategjinë

Zbatimi i Strategjisë do të kryhet në përputhje me Planin e Veprimit 2025-2027 që është pjesë integrale e Strategjisë. Plani i punës identifikon masa konkrete që do të duhet të zbatohen në kuadër të masave kryesore dhe objektivat specifike të identifikuara, me një afat kohor të përcaktuar, institucionet përgjegjëse dhe burimet e kërkuara financiare. Aktivitetet e Strategjisë do të implementohen nga institucionet e përfshira siç janë të përcaktuara në Planin e Veprimit.

MASH do të përgatisë Raporte Vjetore mbi zbatimin e Planit të Veprimit dhe do të zbatojë kuadrin për mbledhjen e të dhënave dhe monitorimin e Planit të Veprimit. Këto janë të përcaktuara saktësisht në Formularin 6 dhe 7 të Metodologjisë për përgatitjen, zbatimin, monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e strategjive sektoriale, si dhe në Udhëzimet për strukturën, përmbajtjen dhe metodat e përgatitjes, zbatimit, monitorimit, raportimit dhe vlerësimit të strategjive sektoriale dhe shumësektoriale. Plani i Veprimit mbulon periudhën nga viti 2025 deri në vitin 2027.

Mel me mbështetjen e vlerësuesve të jashtëm të pavarur, do të kryejë një vlerësim afatmesëm të zbatimit të Strategjisë/Planit të Veprimit në vitin 2028, duke përfshirë rekomandime për përshtatje të mundshme. Do të jetë e rëndësishme që në procesin e vlerësimit të rezultateve të planeve të veprimit të zbatuara nga keto organe/ekspertë të jashtëm përgjegjës për vlerësimin e pavarur. Kjo mund të bëhet në fund të çdo periudhe të Planit të Veprimit (vlerësimi afatmesëm në fillim të vitit 2028 për periudhën 2025-2027 dhe në fillim të vitit 2031 për periudhën 2028-2030).

Për të pasur një analizë të thelluar të performancës së ndërmarrjeve që morën mbështetje qeveritare/donatore, do të jetë thelbësore që:

Zbatimi i suksesshëm i Strategjisë së Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme për Maqedoninë e Veriut do të varet nga disa **parakushte kryesore**, duke përfshirë faktorët institucionalë, politikë, financiarë që lidhet me palët e interesuara. Ja një përmbledhje e strukturuar:

*Tabela 5 – Parakushtet kryesore për zbatimin me sukses të Strategjisë së Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme 2025-2030 për Republikën e Maqedonisë së Veriut*

Kategoria	Parakusht
<b>Kapaciteti Institucional</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përgjegjësi të qarta institucionale dhe mekanizma koordinimi në të gjitha ministritë dhe agjencitë</li> <li>- Sistemi operativ i MVR me tregues qart të definuara për performancë dhe cikle të raportimit</li> <li>- Staf i trajnuar për MVR, zbatimin e politikave dhe menaxhimin e të dhënave</li> </ul>
<b>Politika dhe Korniza Rregullatore</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përputhja e strategjisë së NVM-ve me planet kombëtare të zhvillimit, strategjitë dixhitale, të gjelbra dhe të inovacionit</li> <li>- Mjedis ligjor dhe rregullator mbështetës për NVM-të (p.sh. regjistrim i thjeshtuar, lehtësime tatimore)</li> </ul>
<b>Angazhimi i palëve të interesuara</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përfshirje aktive e NVM-ve, shoqatave të biznesit, akademisë dhe shoqërisë civile në hartimin dhe zbatimin e politikave</li> <li>- Mekanizma funksionale të dialogut publik-privat</li> </ul>
<b>Burimet Financiare</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Sigurimi i fondeve buxhetore për zbatimin e strategjisë</li> <li>- Qasja në fondet kombëtare dhe ndërkombëtare (BE, donatorë, IFI)</li> <li>- Instrumente mbështetëse për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (grante, garanci krediti, etj.)</li> </ul>
<b>Infrastrukturë Dixhitale dhe Inovacion</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Shërbimet publike dixhitale janë të qasshme për NVM-të</li> <li>- Promovimi i inovacionit dhe transformimit dixhital të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme</li> <li>- Mbështetje e mjaftueshme e IT-së për mbledhjen dhe monitorimin e të dhënave(MVR)</li> </ul>

Kategoria	Parakusht
<b>Monitorimi vlersimi dhe Vlerësimi (MVR)</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Grupi i formuar operativ për MVR me role të qarta</li> <li>- Të dhëna të besueshme dhe në kohë nga burime zyrtare dhe sektoriale</li> <li>- Rishikime periodike dhe vlerësime të jashtme (p.sh. rishikim afatmesëm) për të udhëhequr zbatimin</li> </ul>

---

## 6.2. Treguesit kryesorë dhe indikatorë të cilat e tregojnë suksesin e zbatimit të masave dhe aktiviteteve të strategjisë së NVM-ve 2025-2030

Për të siguruar zbatimin efektiv dhe llogaridhënien e Strategjisë Kombëtare për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme 2025-2030, është thelbësore të përcaktohen tregues të qartë dhe të matshëm për secilën nga tre fushat prioritare:

- Një ekosistem konkurrues kombëtar sipërmarrës,
- Qasja në financa, dhe
- Tranzicioni i gjelbër dhe dixhital.

Treguesit kryesorë të ndikimit në nivelin e tre fushave prioritare demonstrojnë ndikimin pozitiv afatgjatë në ekosistemin sipërmarrës në Maqedoninë e Veriut.

Tabela në vijim paraqet treguesit kryesorë në nivelin e fushave prioritare dhe pasqyron ndryshime të rëndësishme pozitive dhe transformuese që do të përmirësojnë pozicionin konkurrues të Maqedonisë së Veriut në skenën ekonomike globale.

FUSHAT ME PRIORITET	TREGUESIT																																						
<b>FUSHA PRIORITARE 1:</b> <b>Një ekosistem konkurrues kombëtar sipërmarrës</b>	<p><b>Renditje e përmirësuar në lidhje me tabelën e rezultateve inovative evropiane</b></p> <table border="1" data-bbox="506 415 1432 579"> <thead> <tr> <th>2023.</th> <th>2027.</th> <th>2030.</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>34</td> <td>28</td> <td>26</td> </tr> <tr> <td>Periudha e monitorimit:</td> <td>Vlerësimi afatmesëm</td> <td>Vlerësimi përfundimtar</td> </tr> </tbody> </table> <p><b>Përfshirja e Maqedonisë së Veriut në Renditjen Botërore të Konkurrueshmërisë të kryer nga Instituti Ndërkombëtar për Zhvillimin e Menaxhimit (IMD)</b></p> <table border="1" data-bbox="506 730 1432 928"> <thead> <tr> <th>2023.</th> <th>2027.</th> <th>2030.</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Pa të dhëna</td> <td>MK është përfshirë në renditjen IMD</td> <td>Lëvizje 10 pozicione më lart krahasuar me vitin 2027.</td> </tr> <tr> <td>Periudha e monitorimit:</td> <td>Vlerësimi afatmesëm</td> <td>Vlerësimi përfundimtar</td> </tr> </tbody> </table> <p><b>Rritja e kostove për kërkim dhe zhvillim në PBB nga NVM-të</b></p> <table border="1" data-bbox="506 1016 1432 1155"> <thead> <tr> <th>2022.</th> <th>2027.</th> <th>2030.</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>0.38</td> <td>0.55</td> <td>0.80</td> </tr> <tr> <td>Periudha e monitorimit:</td> <td>Vlerësimi afatmesëm</td> <td>Vlerësimi përfundimtar</td> </tr> </tbody> </table> <p><b>Rritja e pjesëmarrjes së NVM-ve në eksporte</b></p> <table border="1" data-bbox="506 1243 1432 1381"> <thead> <tr> <th>2024</th> <th>2027</th> <th>2030</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>5%</td> <td>5.4%</td> <td>6%</td> </tr> <tr> <td>Periudha e monitorimit:</td> <td>Vlerësimi afatmesëm</td> <td>Vlerësimi përfundimtar</td> </tr> </tbody> </table>			2023.	2027.	2030.	34	28	26	Periudha e monitorimit:	Vlerësimi afatmesëm	Vlerësimi përfundimtar	2023.	2027.	2030.	Pa të dhëna	MK është përfshirë në renditjen IMD	Lëvizje 10 pozicione më lart krahasuar me vitin 2027.	Periudha e monitorimit:	Vlerësimi afatmesëm	Vlerësimi përfundimtar	2022.	2027.	2030.	0.38	0.55	0.80	Periudha e monitorimit:	Vlerësimi afatmesëm	Vlerësimi përfundimtar	2024	2027	2030	5%	5.4%	6%	Periudha e monitorimit:	Vlerësimi afatmesëm	Vlerësimi përfundimtar
2023.	2027.	2030.																																					
34	28	26																																					
Periudha e monitorimit:	Vlerësimi afatmesëm	Vlerësimi përfundimtar																																					
2023.	2027.	2030.																																					
Pa të dhëna	MK është përfshirë në renditjen IMD	Lëvizje 10 pozicione më lart krahasuar me vitin 2027.																																					
Periudha e monitorimit:	Vlerësimi afatmesëm	Vlerësimi përfundimtar																																					
2022.	2027.	2030.																																					
0.38	0.55	0.80																																					
Periudha e monitorimit:	Vlerësimi afatmesëm	Vlerësimi përfundimtar																																					
2024	2027	2030																																					
5%	5.4%	6%																																					
Periudha e monitorimit:	Vlerësimi afatmesëm	Vlerësimi përfundimtar																																					
<b>FUSHA PRIORITARE 2:</b> <b>Qasja në financa</b>	<p><b>Fluksi neto i investimeve të huaja (IHD) në miliona euro</b></p> <table border="1" data-bbox="506 1533 1432 1696"> <thead> <tr> <th>2023.</th> <th>2027.</th> <th>2030.</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>616.7</td> <td>800</td> <td>1,000</td> </tr> <tr> <td>Periudha e monitorimit:</td> <td>Vlerësimi afatmesëm</td> <td>Vlerësimi përfundimtar</td> </tr> </tbody> </table>			2023.	2027.	2030.	616.7	800	1,000	Periudha e monitorimit:	Vlerësimi afatmesëm	Vlerësimi përfundimtar																											
2023.	2027.	2030.																																					
616.7	800	1,000																																					
Periudha e monitorimit:	Vlerësimi afatmesëm	Vlerësimi përfundimtar																																					

	<b>Burimet e disponueshme përmes fondeve VC në miliona euro</b>		
	<b>2024.</b>	<b>2027.</b>	<b>2030.</b>
	27	35	50
	Periudha e monitorimit:	Vlerësimi afatmesëm	Vlerësimi përfundimtar
<b>FUSHA PRIORITARE 3: Tranzicioni i gjelbër dhe dixhital</b>	<b>Integrimi i rritjes në performancën e teknologjisë dixhitale (DESI)</b>		
	<b>2023.</b>	<b>2027.</b>	<b>2030.</b>
	4.0	5.3	6.7
	Periudha e monitorimit:	Vlerësimi afatmesëm	Vlerësimi përfundimtar
	<b>Pjesa e vlerës së mallrave dhe shërbimeve përfundimtare të prodhuara në sektorin e TIK-ut në Maqedoninë e Veriut e shprehur në njësi monetare në përqindje (% e PBB-së)</b>		
	<b>2022.</b>	<b>2027.</b>	<b>2030.</b>
	3.5%	5%	6.7%
	Periudha e monitorimit:	Vlerësimi afatmesëm	Vlerësimi përfundimtar

Tabela 15 - Një listë e treguesve në Nivelin e Fushave Prioritare

Strategjia përfshin jo vetëm tregues të ndikimit, por edhe tregues të nivelit të rezultateve të lidhura me objektiva specifike, si dhe tregues për masa dhe aktivitete individuale. Ndërsa këta tregues ofrojnë informacion më të detajuar, ata mund të përshtaten gjatë procesit të monitorimit dhe vlerësimit. Ata do të rishikohen çdo tre vjet. Për këtë arsye, këta tregues nuk përfshihen në tekstin integral të Strategjisë, por paraqiten në Planin e Veprimit.

Këta tregues do të lehtësojnë ndjekjen e rregullt të progresit, do të mbështesin vendimmarrjen e bazuar në prova dhe do të ofrojnë sinjale të hershme për çdo përshtatje të nevojshme të politikave. Pa të dhëna të besueshme dhe një sistem të strukturuar dhe sistem të strukturuar për monitorimin e daljeve, rezultatit dhe ndikimi, objektivat strategjike rrezikojnë do të jenë në rrezik të mbeten vetëm deklarative dhe jo transformuese.

Një qasje serioze dhe sistematike ndaj monitorimit dhe vlerësimit është thelbësore për të siguruar që Strategjia të mbetet dinamike, e përgjegjshme dhe në përputhje me prioritetet kombëtare të zhvillimit. Vetëm nëpërmjet vlerësimit dhe përshtatjes së vazhdueshme mund të arrihen dhe të mbështeten ndikimet e planifikuara.

## 7. Menaxhimi i riskut

Menaxhimi i riskut është thelbësor në zbatimin e dokumenteve të politikave për disa arsye, pasi siguron që politikat të arrijnë rezultatet e synuara në mënyrë efektive, duke minimizuar ndikimet e mundshme negative. Duke krijuar një sistem menaxhimi të riskut (duke përfshirë një sistem paralajmërimi të hershëm) si pjesë integrale e kuadrit të monitorimit dhe vlerësimit, ai do të kontribuojë në parandalimin e rreziqeve të politikave dhe aktivizimin e masave zbutëse për të kapërcyer rreziqet e mundshme dhe të vazhdueshme. Kjo do të rrisë efektivitetin e politikave, do të mbështesë proceset e vendimmarrjes, do të mundësojë planifikim efikas të burimeve financiare dhe do të sigurojë zbatimin në kohë të aktiviteteve dhe planit të veprimit.

Bazuar në analizat e kryera gjatë përgatitjes së kësaj Strategjie për NVM-të, si dhe në studimet, kërkimet dhe raportet nga organizatat ndërkombëtare, OJQ-të, academia dhe burime të tjera relevante, janë identifikuar disa rreziqe të mundshme që mund të ndikojnë në arritjen me sukses të rezultateve të parashikuara të strategjinë.

Këto rreziqe theksojnë rëndësinë e përcaktimit dhe zbatimit të masave proaktive zbutëse për të siguruar jo vetëm arritjen, por edhe mirëmbajtjen afatgjatë të objektivave strategjike. Në tabelën më poshtë, Tabela 4, shqyrtohen rreziqet e identifikuar, së bashku me gjasat e tyre të ndodhjes dhe ndikimet e mundshme, si dhe një kornizë gjithëpërfshirëse të hartuar për menaxhim efektiv dhe minimizim të efekteve të tyre. Duke shfrytëzuar njohuritë nga një gamë e gjerë palësh të interesuara, strategjia synon të kapërcejë sfidat duke ruajtur një angazhim për të nxitur një sektor të NVM-ve rezistent dhe prosperues.

*Tabela 4. Rreziqet e mundshme të identifikuar dhe masat për zbutjen e tyre*

Rrezik	Probabiliteti i paraqitjes së riskut	Ndikimi i rrezikut në arritjen e objektivave	Masat për Zbutjen e Rrezikut
<b>Burime njerëzore institucionale të pamjaftueshme dhe kapacitet i pamjaftueshëm për zbatimin e strategjisë</b>	<b>Mesatare</b>	<b>Mesatare</b>	Emërimi relevant i përfaqësuesve nga palët e interesuara për të mbështetur zbatimin e strategjisë është me rëndësi thelbësore. Në disa institucione, një person mund të jetë i mjaftueshëm, ndërsa në të tjerat, disa individë mund të përfshihen në proces. Nga ana tjetër, kapacitetet e tyre gjithashtu duhet të forcohen rregullisht në mënyrë që të përballen me sfidat e kërkuara. Kjo përfshin pjesëmarrjen në punëtori, konferenca, vizita studimore përkatëse, përfshirjen e tyre në proceset e vlerësimit të treguesve të krahasueshme dhe aktivitete të tjera.
<b>Aktivitete të pamjaftueshme</b>	<b>Mesatare</b>	<b>Mesatare</b>	Strategjia duhet të mbështetet nga të gjithë palët e interesuara të përfshira në proces,

Rrezik	Probabiliteti i paraqitjes së riskut	Ndikimi i rrezikut në arrijtjen e objektivave	Masat për Zbutjen e Rrezikut
për nfrityjen e ndërgjegjësimit në lidhje me përmbajtjen e strategjisë			nga ata që janë përgjegjës për zbatimin e saj deri te përfituesit përfundimtarë. Është thelbësore të zhvillohet një strategji gjithëpërfshirëse komunikimi që siguron përhapjen e qartë të objektivave të reformës, përfitimeve dhe detajeve të zbatimit tek të gjithë palët e interesuara. Kjo mund të arrihet përmes fushatave të synuara të informimit, materialeve informuese dhe seancave interaktive, të tilla si punëtori ose webinarë, të dizajnuara për të angazhuar dhe edukuar publikun dhe palët e interesuara përkatëse. Kanalet transparente të komunikimit dhe përditësimet e rregullta do të luajnë gjithashtu një rol jetësor në ndërtimin e besimit dhe nxitjen e mbështetjes për reformën.
Mungesa e mbështetjes së nevojshme financiare për të zbatuar aktivitetet dhe masat e planifikuara	<b>I lartë</b>	<b>I lartë</b>	Identifikimi i qartë i kostove dhe përputhja e tyre me burimet e financimit mund të përmirësojë planifikimin financiar. Rishikimi i rregullt i zbatimit të strategjisë duhet t'i paraqitet gjithashtu Qeverisë, së bashku me një plan financimi për periudhën e ardhshme. Mbajtja e takimeve të rregullta me komunitetin e donatorëve dhe partnerë të tjerë ndërkombëtarë, si dhe paraqitja e planeve të zbatimit në të ardhmen, mund të çojë në një koordinim më të mirë dhe potencialisht të sigurojë fonde shtesë nga burimet e tyre për aktivitetet e nevojshme. Të gjitha këto përpjekje mund të kontribuojnë në ngushtimin e hendekut financiar dhe potencialisht në sigurimin e fondeve të mjaftueshme për zbatimin e strategjisë, programeve dhe masave të saj.
Zbatim i vonuar	<b>I lartë</b>	<b>Mesatare</b>	Vonesat në zbatim mund të dëmtojnë ndjeshëm suksesin dhe ndikimin e reformës. Për të adresuar këtë rrezik, është thelbësore të përcaktohen afate të qarta

Rrezik	Probabiliteti i paraqitjes së riskut	Ndikimi i rrezikut në arritjen e objektivave	Masat për Zbutjen e Rrezikut
			<p>kohore me momente të matshme dhe të monitorohet nga afër progresi përmes praktikave të fuqishme të menaxhimit të projekteve. Duhet të vendosen mekanizma të rregullt raportimi dhe llogaridhënieje për të siguruar respektimin e afateve. Përveç kësaj, identifikimi dhe adresimi i pengesave të mundshme që në fillim, së bashku me planifikimin e emergjencës, mund të ndihmojë në zbutjen e vonesave. Përmirësimi i koordinimit midis palëve të interesuara dhe sigurimi që burimet e mjaftueshme të jenë të disponueshme në kohën e duhur do të mbështesë më tej ekzekutimin efikas dhe në kohë të strategjisë. Së fundmi, mbajtja e palëve të interesuara përgjegjëse për detyrat e tyre është thelbësore në shtyrjen përpara të zbatimit.</p>
<b>Krizat, tronditjet dhe rreziqet globale</b>	<b>I ulët</b>	<b>Mesatare</b>	<p>Krizat globale si pandemitë, konfliktet gjeopolitike ose fatkeqësitë natyrore mund të prishin rëndë buxhetin kombëtar dhe mund të krijojnë nevojën për rishpërndarje të buxhetit, gjë që mund të ndikojë në zbatimin e strategjisë dhe veprimin e saj. Një çështje për të zbutur këto rreziqe është përcaktimi i përparësive të aktiviteteve me rëndësi thelbësore në mënyrë që ato të zbatohen të parat dhe pjesa tjetër të zbatohet pasi të ketë kaluar kriza.</p>
<b>Strategji e pamjaftueshme për MVR</b>	<b>Mesatare</b>	<b>Mesatare</b>	<p>Mungesa e sistemeve të fuqishme për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të strategjisë dobëson ndikimin e përgjithshëm. Për të parandaluar dështimet e mundshme, është e rëndësishme të ndërmerren masat e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përcaktimi i Treguesve Kyç të Performancës (KPI) specifike të lidhur me qëllimet strategjike.</li> </ul>

Rrezik	Probabiliteti i paraqitjes së riskut	Ndikimi i rrezikut në arritjen e objektivave	Masat për Zbutjen e Rrezikut
			<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vendosja e objektiva të matshme me afate kohore dhe momente kyçe.</li> <li>• Caktimi i detyrave dhe përgjegjësi për çdo performans ose objektiv.</li> <li>• Caktoni një person/departament që do të monitorojë rregullisht zbatimin dhe do të përgatisë raporte në lidhje me progresin. Kjo mund të bëhet edhe me nënkontraktim, gjë që do të kërkojë burime shtesë financiare, por do të sigurojë transparencë dhe objektivitet në procesin e përgjithshëm.</li> <li>• Ofroni trajnime të rregullta për ata që janë përgjegjës për monitorimin e procesit të zbatimit.</li> </ul>
<p><b>Jopërgaditje e mire për ndryshime në aspekt të mungesës së kapaciteteve( numri I të punësurve) në institucionet</b></p>	<p><b>Mesatare</b></p>	<p><b>I lartë</b></p>	<p>Rezistenca ndaj ndryshimit dhe angazhimi i pamjaftueshëm nga punonjësit mund të pengojnë zbatimin me sukses të strategjisë. Për ta adresuar këtë, është thelbësore të nxitet një kulturë hapjeje dhe përfshirjeje duke i përfshirë në mënyrë aktive punonjësit në procesin e reformës dhe duke u siguruar që zërat e tyre të dëgjohen. Ofrimi i një komunikimi të qartë në lidhje me objektivat, përfitimet dhe ndikimin e reformave mund të ndihmojë në zbutjen e shqetësimeve dhe në ndërtimin e besimit. Ofrimi i programeve të trajnimit për të rritur gatishmërinë e punonjësve për ndryshim, së bashku me stimulimet dhe njohjen për kontributet e tyre, mund të rrisë më tej angazhimin dhe dedikimin. Lidershipi gjithashtu duhet të luajë një rol aktiv në dhënien e shembullit dhe në demonstrimin e rëndësisë së reformave për suksesin e organizatës. Sigurisht, një kusht kyç për të gjitha këto është që të gjitha pozicionet e punës të plotësohen me staf të përshtatshëm.</p>

Rrezik	Probabiliteti i paraqitjes së riskut	Ndikimi i rrezikut në arritjen e objektivave	Masat për Zbutjen e Rrezikut
<p><b>Ndryshimi i personelit kyç brenda grupit të punës ose institucioneve udhëheqëse</b></p>	<p><b>Mesatare</b></p>	<p><b>I ulët</b></p>	<p>Ndryshimet e stafit brenda institucioneve, duke përfshirë edhe Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës , si dhe midis vendimmarrësve të tjerë të përfshirë drejtpërdrejt, mund të çojnë në vonesa në zbatimin e strategjisë.</p> <p>Për të zbutur këtë rrezik, është e rëndësishme të identifikohen rolet kritike dhe të zhvillohet një plan trashëgimie për secilën pozicion, veçanërisht në nivelin e grupit të punës.</p>

## 8. Referencat

- {COM(2020) 641 final}, [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2020-10/green\\_agenda\\_for\\_the\\_western\\_balkans\\_en.pdf](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2020-10/green_agenda_for_the_western_balkans_en.pdf)
- {SEC(2008) 2101} {SEC(2008) 2102}, <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52008DC0394>
- COM (2021) 350/2, [https://commission.europa.eu/document/download/9ab0244c-6ca3-4b11-bef9-422c7eb34f39\\_en?filename=communication-industrial-strategy-update-2020\\_en.pdf](https://commission.europa.eu/document/download/9ab0244c-6ca3-4b11-bef9-422c7eb34f39_en?filename=communication-industrial-strategy-update-2020_en.pdf)
- COM(2019) 640 final, <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=CELEX:52019DC0640>
- COM(2023) 535 final, [https://single-market-economy.ec.europa.eu/document/download/8b64cc33-b9d9-4a73-b470-8fae8a59dba5\\_en?filename=COM\\_2023\\_535\\_2023\\_535\\_1\\_1\\_EN](https://single-market-economy.ec.europa.eu/document/download/8b64cc33-b9d9-4a73-b470-8fae8a59dba5_en?filename=COM_2023_535_2023_535_1_1_EN)
- COM(2023) 62 final, <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52023DC0062>
- COM (2023) 691 final, [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/8f5dbe63-e951-4180-9c32-298cae022d03\\_en?filename=COM\\_2023\\_691\\_New%20Growth%20nkans%20We](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/8f5dbe63-e951-4180-9c32-298cae022d03_en?filename=COM_2023_691_New%20Growth%20nkans%20We)
- COM/2020/103; <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52020DC0103>
- [https://commission.europa.eu/funding-tenders/find-funding/eu-funding-programmes/single-market-programme\\_en](https://commission.europa.eu/funding-tenders/find-funding/eu-funding-programmes/single-market-programme_en)
- [https://commission.europa.eu/law/law-making-process/evaluating-and-improving-existing-laws/refit-making-eu-law-simpler-less-costly-and-future-proof\\_en](https://commission.europa.eu/law/law-making-process/evaluating-and-improving-existing-laws/refit-making-eu-law-simpler-less-costly-and-future-proof_en)
- [https://commission.europa.eu/law/law-making-process/planning-and-proposing-law/better-regulation\\_en#documents](https://commission.europa.eu/law/law-making-process/planning-and-proposing-law/better-regulation_en#documents)
- [https://commission.europa.eu/news/once-only-principle-system-breakthrough-eus-digital-single-market-2020-11-05\\_en](https://commission.europa.eu/news/once-only-principle-system-breakthrough-eus-digital-single-market-2020-11-05_en)
- <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/PE-80-2024-INIT/en/pdf>
- <https://digital-strategy.ec.europa.eu/en/policies/europes-digital-decade>
- <https://dksk.mk/wp-content/uploads/2021/01/Nacionalna-strategija-DKSK-KONECNA.pdf>
- [https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/fr/memo\\_11\\_109](https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/fr/memo_11_109)
- <https://ec.europa.eu/eurostat/web/microdata/community-innovation-survey>
- <https://economy.gov.mk/content/documents/Web%20strana%20zabeleshki%20od%20Agencija%20za%20primena%20na%20jazikot%20na%20RSM%2007.07.2021.pdf>
- <https://een.ec.europa.eu/>
- [https://eisma.ec.europa.eu/programmes/single-market-programme/support-smes\\_en](https://eisma.ec.europa.eu/programmes/single-market-programme/support-smes_en)
- [https://ener.gov.mk/PublicDocuments/%D0%9D%D0%B0%D1%86%D0%B8%D0BE%D0BD%D0B0%D0BB%D0BD%D0B0%20%D0%98%D0%9A%D0%A2%20%D0%A1%D1%82%D1%80%D0B0%D1%82%D0B5%D0B3%D0B8%D1%98%D0B0%20%D0B7%D0B0%202023%20-2027%20%D0B3%D0BE%D0B4%D0B8%D0BD%D0B0%20-%20%D0%94%D1%80%D0B0%D1%84%D1%82\\_%D0%9D%D0B0%D1%86%D1%80%D1%82\\_id=46\\_version=1.pdf](https://ener.gov.mk/PublicDocuments/%D0%9D%D0%B0%D1%86%D0%B8%D0BE%D0BD%D0B0%D0BB%D0BD%D0B0%20%D0%98%D0%9A%D0%A2%20%D0%A1%D1%82%D1%80%D0B0%D1%82%D0B5%D0B3%D0B8%D1%98%D0B0%20%D0B7%D0B0%202023%20-2027%20%D0B3%D0BE%D0B4%D0B8%D0BD%D0B0%20-%20%D0%94%D1%80%D0B0%D1%84%D1%82_%D0%9D%D0B0%D1%86%D1%80%D1%82_id=46_version=1.pdf)
- <https://entrecomp360.eu/toolbox/entrecom4all/>
- <https://eufordigital.eu/discover-eu/eu-digital-strategy/>
- <https://eur-lex.europa.eu/EN/legal-content/summary/european-charter-for-small-enterprises.html>
- <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32021R1060&from=EN>
- <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52023PC0533> , COM(2023) 533 final/2,
- [https://eur-lex.europa.eu/resource.html?uri=cellar:12e835e2-81af-11eb-9ac9-01aa75ed71a1.0001.02/DOC\\_1&format=PDF](https://eur-lex.europa.eu/resource.html?uri=cellar:12e835e2-81af-11eb-9ac9-01aa75ed71a1.0001.02/DOC_1&format=PDF)
- [https://finance.ec.europa.eu/capital-markets-union-and-financial-markets/capital-markets-union/what-capital-markets-union\\_en](https://finance.ec.europa.eu/capital-markets-union-and-financial-markets/capital-markets-union/what-capital-markets-union_en)
- [https://finance.gov.mk/wp-content/uploads/2022/01/Growth-Acceleration-Plan\\_final-1.doc](https://finance.gov.mk/wp-content/uploads/2022/01/Growth-Acceleration-Plan_final-1.doc)

- <https://gemconsortium.org/economy-profiles/macedonia>
- <https://innovationdistrictcopenhagen.dk/>
- <https://innovationdistrictcopenhagen.dk/> (Një shembull i një distrikti inovacioni të themeluar në pranverën e vitit 2024.
- <https://mapas.mk/wp-content/uploads/2023/07/fintech-strategy-for-financial-regulators.pdf>
- [https://mep.gov.mk/data/MK\\_Reform%20Agenda\\_EN.pdf](https://mep.gov.mk/data/MK_Reform%20Agenda_EN.pdf)
- <https://mls.gov.mk/files/Strategija-Za-RRR.pdf>
- <https://mon.gov.mk/stored/document/Draft%20S3%20MK.pdf>
- [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/5f0c9185-ce46-46fc-bf44-82318ab47e88\\_en?filename=North%20Macedonia%20Report%202024.pdf](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/5f0c9185-ce46-46fc-bf44-82318ab47e88_en?filename=North%20Macedonia%20Report%202024.pdf)
- [https://research-and-innovation.ec.europa.eu/statistics/performance-indicators/european-innovation-scoreboard\\_en](https://research-and-innovation.ec.europa.eu/statistics/performance-indicators/european-innovation-scoreboard_en)
- <https://scienceparkboras.se/>
- [https://single-market-economy.ec.europa.eu/document/download/2bef0eda-2f75-497d-982e-c0d1cea57c0e\\_en?filename=Annual%20Report%20on%20European%20SMEs%202024.pdf](https://single-market-economy.ec.europa.eu/document/download/2bef0eda-2f75-497d-982e-c0d1cea57c0e_en?filename=Annual%20Report%20on%20European%20SMEs%202024.pdf)
- [https://single-market-economy.ec.europa.eu/smes/challenges-and-resilience/late-payment\\_en](https://single-market-economy.ec.europa.eu/smes/challenges-and-resilience/late-payment_en)
- [https://single-market-economy.ec.europa.eu/smes/sme-strategy-and-sme-friendly-business-conditions/sme-test\\_en](https://single-market-economy.ec.europa.eu/smes/sme-strategy-and-sme-friendly-business-conditions/sme-test_en)
- [https://taxation-customs.ec.europa.eu/taxation/business-taxation/head-office-tax-system-smes-hot\\_en](https://taxation-customs.ec.europa.eu/taxation/business-taxation/head-office-tax-system-smes-hot_en)
- <https://thepark.cz/en/location>
- <https://trainsonline.unctad.org/home>
- [https://view.officeapps.live.com/op/view.aspx?src=https%3A%2F%2Ffinance.gov.mk%2Fwp-content%2Fuploads%2F2023%2F09%2FStrategija-za-neformalna-ekonomija-2023-2027\\_korekcija-28082023-2-1.docx](https://view.officeapps.live.com/op/view.aspx?src=https%3A%2F%2Ffinance.gov.mk%2Fwp-content%2Fuploads%2F2023%2F09%2FStrategija-za-neformalna-ekonomija-2023-2027_korekcija-28082023-2-1.docx)
- <https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/programa-na-vladata-2024-2028.pdf>
- <https://vtpplzen.cz/en/>
- [https://www.berlinprocess.de/uploads/documents/common-regional-market-action-plan-2025-2028\\_1728992448.pdf](https://www.berlinprocess.de/uploads/documents/common-regional-market-action-plan-2025-2028_1728992448.pdf)
- <https://www.clustercollaboration.eu/>
